

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXIV - Nr. 7724 E enjte 29 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** **Ditës**
Pavarësisht debeteve se i fundmi gjerman iku në sekondat e fundit të datës 28 apo në sekondat e para të 29 nëntorit 1944, zyrtarisht, sot kemi festë. Edhe pse ...
Vijon në faqen 20

Nga XHEVAT MUSTAFA
74 vjet çlirim nga fashizmi dhe "pushim" nga ... vetvetja


Opinion **i** **Ditës**
Aktualisht të gjitha informacionet A çojnë në një konkludim: Konflikti i ri mes Ukrainës dhe Rusisë duket i pashmangshëm. Presidenti Petro Poroshenko ...
Vijon në faqen 21

Nga "DEUTSCHE WELLE"
Ukrainë: Rreziku nga "lufta totale"

Dita e Flamurit, urojnë Trump e Putin

Meta: BE, mision i papërbushur. Duhet bashkëpunim maxhorancë-opozitë

Nderohet ish-presidenti kroat, Stipe Mesiç. Rama në Vlorë, Basha homazhe të "Dëshmorët"

VALENTINA MADANI

Edhe ky 106-vjetor i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë e gjeti dje të ndarë politikën shqiptare. Në Vlorë u organizua aktiviteti me rastin e 28 Nëntorit, ku të pranishëm ishin zyrtarë të lartë të shtetit, presidenti Meta ...

Në faqen 2

PROJEKTIGJI/ PAJISEN ME LEJE OBJEKTET QE NDERTOHEN BRENDA VITIT

LEGALIZIMET, QEVERIA SHTYN AFATIN DERI ME 31 DHJETOR

Me ligjin ekzistues legalizohen objektet që janë ndërtuar deri në 2014, pritet hapja e procesit të ri. Si vepohet me ndërtimet që u ka falimentuar ndërtuesi



(Në foto) Zonë informale

Në faqet 4-5

BIZNESMENI

U kap në kufi me pasaportë false, lirohet nga qelia "i forti" i Shkodrës

Në faqen 8

TRAFIKU I DROGËS

Kamioni me 2.5 tonë hashash që u kap në Itali, çohen në gjykim 9 trafikantë

Në faqen 6

THAÇI TAKON POMPEON

Dialogu Kosovë-Serbi, SHBA: Koha për marrëveshje mes dy shteteve

Në faqen 14

TENSIONI NE LINDJE

Arrestimi i 24 marinarëve, Ukraina në prag lufte me Rusinë

Në faqen 15

DYSHIMI PER DROGE



Vrasja në Bllok, shpallet në kërkim biznesmeni që pati konflikt me Matën

Në faqen 7

Flet kreu i shoqatës, Thoma Konduri: Kategoritë që preken nga vendimi i gjykatës

Ushtarakët, ja kush duhet të kthejë paratë në shtet

Eksperti i pensioneve, Kosta Bajraba: Faji i qeverive, çështje e ndërlikuar

Nga VOLTIZA DURO

Mbi 1 mijë ushtarakët që kanë fituar gjyqet që mbi pensionet e paraqohshme ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore duhet të kthejnë mbrapsht paratë që kanë marrë nga vendimet që formës së prerë. Njëpërmjet



Thoma Konduri



një vendimi unifikues, Gjykata e Lartë ka rrezuar vendimet që kanë shpallur fitues të proceseve gjyqësore ushtarakët e si pasojë këta të fundit duhet të dorëzojnë 2.37 milionë lekë të vjetra. Në një intervistë për "Gazetën Shqiptare", Thoma Konduri, president ...

Në faqet 10-11

PAVARESIA MESAZHET

PD te 'Dëshmorët e Kombit', Basha: Për lirinë luftohet çdo ditë

Presidenti Meta, apel politikës: Bashkëpunim mes pozitës e opozitës

Politika feston e ndarë festën e Pavarësisë

Valentina Madani

Edhe ky 106-vjetor i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë e gjeiti dje të ndarë politikën shqiptare. Në Vlorë u organizua aktiviteti me rastin e 28-Nëntorit ku të pranishëm ishin zyrtarë të lartë të shtetit, presidenti Meta, kryeparlamentari Ruçi dhe kryeministri Rama. Presidenti Meta dhe kryeministri Rama zhvilluan homazhe dhe vendosen kurora me lule në Monumentin e Pavarësisë. Pjesë e homazheve ishte edhe zv/kryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli.

Kreu i shtetit, Ilir Meta, i bëri një apel politikës së duhet të bashkëpunojë për funksionim sa më të mirë të shtetit ligjor. "Funksionimi i shtetit ligjor dhe institucionet e pavarura kërkojnë dialog dhe bashkëpunim të qëndrueshëm mes shumicës dhe opozitës", tha z.Meta. Në pritjen shtetërore të organizuar në Pallatin e Brigadave me rastin e festës kombëtare, Ditës së Pavarësisë dhe të Flamurit, Presidenti Meta tha se ende nuk është përmbytur misioni për integrimin në BE. "Populli shqiptar arriti të afirmohet si identiteti historik, kulturor dhe evropian deri në ditët tona. Kohët kanë ndryshuar, por trashëgimia e vlerave identitare dhe kulturore si dhe parimeve shtetformuese që lanë pas që nga heroi ynë kombëtar, Skënderbeu e deri tek Ismail Qemali dhe shumë patriotë mendjendritur të Rilindjes Kombëtare janë apeluere dhe aktualë edhe sot e kësaj dite. Kthimi i Shqipërisë dhe shqiptarëve në familjen europiane është një mision ende i papërmbytur tërësisht për ne", deklaroi z.Meta. Të pranishëm në ceremoni ishte i pranishëm kryeministri Edi Rama dhe kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi. Gjatë fjalës së tij, Meta përmendi se Shqipëria duhet të zgjidhë çështjet e emigracionit, ndërsa tha se, "kjo është kamberi alarmi për klasën politike". Sipas tij, "sfidat kërkojnë bashkëpunim për një klimë politike konstruktive, ku të drejtat njerëzore duhet të jenë prioritet i të gjithëve".

OPOZITA

PD-ja zhvilloi homazhe te varrezat 'Dëshmorët e Kombit' në Tiranë. Kreu i opozitës ftoi shqiptarët të jenë të bashkuar për të siguruar, siç tha ai, liri të pacenuar. "Jam sot në krah të gjithë qytetarëve që janë ngritur për të mbrojtur lirinë e tyre dhe të drejtat e tyre. Dhe e konsideroj ditën e sotme edhe një



Presidenti Meta, kryeparlamentari Ruçi dhe kryeministri Rama, dje në Pallatin e Brigadave

KUVENDI

Me rastin e 106-vjetorit të Pavarësisë, parlamenti është vizituar nga shqiptarët që jetojnë brenda dhe jashtë vendit. Me urimet e tyre, për një Shqipëri të anëtarësuar në Bashkimin Europian, kishte edhe nga ato qytetarë që shprehën pakënaqësitë për klasën politike.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha dhe drejtuesit e PD-së, gjatë homazheve te 'Dëshmorët e Kombit'

Putin, Metës: Bashkëpunimi ruso-shqiptar, në interes të Europës

Presidenti i Rusisë Vladimir Putin i përcolli dje një mesazh urimi presidentit të Shqipërisë Ilir Meta me rastin e Ditës së Flamurit. Në mesazhin e urimit presidenti shpreh sigurinë se zhvillimi i marrëdhënieve konstruktive dhe bashkëpunimit dypalësh ruso-shqiptar në fusha të ndryshme do të ishte në interes të popujve të dy vendeve tona, si edhe të gjithë Evropës. "I nderuar zoti President, Pranoni urimet e mia me rastin e festës kombëtare të Shqipërisë, Ditës së Flamurit. Jam i sigurt se zhvillimi i marrëdhënieve konstruktive dhe bashkëpunimit dypalësh ruso-shqiptar në fusha të ndryshme do të ishte në interes të popujve të dy vendeve tona, si edhe të gjithë Evropës. Ju uroj Juve shëndet dhe suksese, ndërsa të gjithë bashkëqytetarëve Tuaj u uroj mirëqenie dhe begati", shkruan Putin.

ftesë për një bashkim të madh të gjithë shqiptarëve në një betejë të përditshme e papushim derisa liria e çdo shqiptari të jetë e pacenuar dhe e garantuar, në fakt, ashtu siç

Urimet e liderëve botërorë për Ditën e Pavarësisë

Trump: Jemi krenarë për bashkëpunimin, Shqipëria një aleate e vyer

Me rastin e 106-vjetorit të Ditës së Pavarësisë dhe të Flamurit, Presidenti i Republikës, Ilir Meta, ka marrë mesazhe të shumta urimi nga krerë shtetesh të vendeve mike e partnere të Shqipërisë. Në mesazhin e tij Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald J. Trump, thekson se: "Jemi krenarë për marrëdhënien e fortë që dy kombet tona kanë zhvilluar dhe arritjet domethënëse që kemi realizuar së bashku. Shqipëria është një aleate e vyer, që ka dhënë një kontribut domethënës për sigurinë rajonale dhe atë globale". Ndërsa, Presidenti Italian Sergio Mattarella, shpreh: "Përkujtimi i përbashkët së fundmi i figurës së Gjergj Kastriotit Skënderbeu, forcoi më tej jo vetëm marrëdhëniet dypalëshe, por edhe ndjenjën e ndarjes bashkërisht të



faqeve të rëndësishme të historisë - siç u dëshmuua konkretisht nga pakica arbëreshe mjaft aktive - si dhe të horizonteve të përbashkëta në gjirin e familjes evropiane dhe të komunitetit euroatlantik". Po ashtu, Presidenti Gjerman, Frank-Walter Steinmeier thekson: "Të jeni të sigurt se Gjermania do të vazhdojë ta mbështesë Shqipërinë në mënyrë aktive në rrugën e saj drejt BE. Mesazhe urimi erdhën edhe nga Presidenti i Turqisë Erdogan, Presidenti i Kinës, Xi

Jinping, Presidentja e Kroacisë, Kitaroviç, Perandori i Japonisë Akihito, Mbreti i Spanjës Felipe VI i Spanjës, Mbreti i Holandës, Willem-Alexander, Presidenti i Polonisë, Andrzej Duda, Presidenti i Bullgarisë, Rumen Radev, Presidenti i Konfederatës Zvicerane, Alain Berset, Presidentja e Estonisë, e Lituaniës, Presidenti i Azerbaixhanit, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Bashkëpunimit Islamik, etj.

e njohur të Ismail Bej Vlorës, i cili shpalli Pavarësinë e Shqipërisë 106 vjet më parë në Vlorë. "Nderim të përjetshëm Ismail Bej Vlorës, burrit të madh të kombit që shpalli në

Vlorë 106 vjet më parë pavarësinë e Shqipërisë dhe bashkëpunëtorëve të tij firmëtarë të aktit të ditëlindjes së Shqipërisë së Pavarur!", shkruan Berisha.

"Dekorata e Flamurit", Meta nderon ish-presidentin kroat

Si një mik i shqiptarëve, i cili mbrojti kauzën dhe të drejtat e tyre në periudhën më të vështirë në luftën kundër Millosheviçit, ish-Presidenti kroat Stjepan Mesiç, mori "Dekoratën e Flamurit Kombëtar" nga Presidenti Meta. Sipas tij ky nderim vjen për përpjekjet e vazhdueshme që ka patur ish-presidenti Mesiç në mbrojtjen e interesave të shqiptarëve në Ballkan. "Presidentin është një mik i pazvëndësueshëm, i cili ka mbrojtur me të drejta e shqiptarëve. Presidenti ka më shumë se 50 vite në mbështetje të shqiptarëve. Në momentet më të vështira të kombit shqiptar, ku regjimi i Millosheviçit ndaj Kosovës e kundërshtoi me forcë, një luftë e cila përgjaku Kosovën. Ai ishte një zë i fortë kundër masakrave dhe spastrimeve etnike, e cila e shoqëroi këtë luftë", tha z.Meta. Vetë Mesiç u shpreh i nderuar nga kjo dekoratë, ndërkohë që në lidhje me korrigjimin e kufijve që po diskutohet sot mes Kosovës dhe Serbisë theksoi se ndryshimi i tyre nuk u arrit as me luftë. E rëndësishme për Mesiç është integrimi në BE, pasi kjo do të jete fund një debati të tillë për kufijtë. Mesiç bëri thirrje BE-së për përshejtimin e integrimin të Europës Juglindore në Bashkimin Europian. Një proces i tillë do të shuante dhe idetë e ndryshimit të kufijve, një ide e kahershme e Millosheviçit, të cilin ai nuk mundi ta realizonte, por që sot, tha Mesiç, ka njerëz që quajnë të mirë. "Një politikë e gabuar: Është e njëjtë sikur të themi në Gjermani, Hitleri ka pasur idetë të mirë, por nuk janë realizuar mirë", tha z.Mesiç.



Ua heqin ndriçimin, banorët rrezojnë blloqet, dëmtojnë pjesën rrethuese të projektit

Banorët e "Astirit" protestojnë me flamurin kombëtar: Nuk tërhiqemi

PD: Veliaj u takua me policët e bashkisë, jo me banorët

Valentina Madani

Nën atmosferën e fes të së pavarësisë dhe simboleve kombëtare, banorët e "Astirit" protestën e djeshme e nisën me flamurin kombëtar, në mbrojtje të banesave të tyre nga prishja për projektin e Unazës së Re. Protestuesit paraditen e djeshme shpalosën një banderolë me një flamur të madh kuq e zi, teksa bllokuan qarkullimin e mjeteve në dy akset e rrugës.

Por, gjatë pasdites situata u tensionua, pasi banorët hoqën blloqet e betonit dhe mjetet rrethuese të projektit që do të vihet në jetë pas shembjes së shtëpive dhe bizneseve pa leje. Duke qenë se i kanë hequr ndriçimin, banorët kanë ndezur të gjithë blloqet e telefonave me thirrjet "Drita jemi ne". Avokati i banorëve të "Astirit", Artan Manushaqe, teksa hodhi akuza ndaj kryeministrit Edi Rama, e paralajmëroi këtë të fundit se projekti i Unazës së Madhe do të jetë dhe funerali i tij politik. "Edi Rama është antishqiptar i madh, njeriu që e po e çon Shqipërinë në greminë, po tenton të çkombëtarizojë Shqipërinë. Rasti tipik është Unaza e Re. Këtu ka shkelje të tërësishme të njeriut. Unaza e Re nuk është një rast. Kemi Bregun e Lumit. Dy lote janë shpronësuar. loti i tretë jo. Në 2015-ën u hoq me VKM. I bëj thirrje Ramës, pse e ke hequr? Pse diskriminohet njerëzit? Edi Rama mban mend, Unaza do të jetë funerali yt politik! Unaza e Re sot është Shqipëria e vogël dhe ju nuk arritët ta përcani dot", deklaroi Manushaqe. Banorët u revoltuan, ndërkohe me thirrjet "Nuk na tremb dot Edvino", ata marshuan përgjatë gjithë rrugës. Për 2 orë ata bllokuan të dy kahet e rrugës, duke mos lejuar qarkullimin e makinave.

DENONCIMI
Prej gati një muaj, banorët e zonës së "Astirit" kundërshtojnë projektin. Në mbështetje të tyre është edhe opozita, e cila e quan projektin si abuzim. Partia Demokratike denoncoi dhe se mbledhja që kryebashkiaku Veliaj pretendon se bëri me banorët e Unazës së Re një ditë më parë është një mashtrim. Teksa qëndronte pranë protestuesve, ku dha edhe mesazhin e festës së flamurit, që është uniteti, deputetja Albana Vokshi tha se ata që u paraqiten në takim ishin policë bashkiakë dhe punonjës të administratës. Vokshi publikoi një foto, sipas së cilës persona janë policë bashkiakë dhe jo banorë.



Protesta e djeshme e banorëve të "Astirit"

Kreu i bashkisë: S'ndalemi nga lëvizja "Dum babën"!

Veliaj: Një banesë e re sociale për banorët e 'Astirit'

Kreu i Bashkisë së Tiranës, Erjon Veliaj, ngriti flamurin në sheshin "Skënderbej" me rastin e 106-vjetorit të pavarësisë. Por, kryebashkiaku u ndal edhe të projekti i Unazës së Re, që sipas tij, do të çlirohet Tiranën nga trafiku i rënduar. "Nëse sot do të dëgjonim lëvizjen 'Dumbabiste', nuk do të kishim këtë shesh, atë pazar, sheshin e lojërave tek Liqeni Artificial. Tirana me Unazën e Madhe do të ketë pavarësi nga trafiku si dhe nga zaptimi. Ky qytet nuk la pa bukë hebrënjët. Ky qytet nuk do të lë asnjë njeri pa bukë, por me ia kemi borxh gjeneratës zhvillimit të Tiranës. Jam mirënjohës për banorët bashkëpunues", tha Veliaj. Po dhe kryebashkiaku vizitoi familjen Pira nga Unaza e Madhe, e sistemuar në banesë sociale. Kryebashkiaku siguroi edhe një herë të gjithë banorët e zonës së "Astirit" se Bashkia e Tiranës dhe institucionet e tjera shtetërore do bëjnë



çdo gjë që është e mundur për të siguruar një strehë dhe kushtet e nevojshme të jetesës. "Ne kemi mbrojtur hebrënjët, nuk i la njeri në Tiranë pa bukë e pa shtëpi, jo më njeri-tjetrin, por tani duhet të kuptojmë që edhe rruga të bëhet, edhe njerëzve t'u japim shtëpi. Ju garantoj se jo vetëm ju, por të gjithë ata që do aplikojnë pas jush, kushdo që do të bashkëpunojë dhe do thotë, orë unë dua të bëhet rruga, por më ofroni diçka, ne jemi këtu që të ofrojmë diçka! Këtu, banesat i kemi pa limit ko-

hor", theksoi kryetari i bashkisë. Ai përsëriti edhe një herë se çdo banori të Unazës që preket ka projektin, por që i mbetet një pjesë tokë që mund ta përdorë si truall, bashkia do t'i ofrojë lejen e ndërimit për të bërë një banesë të re. Sipas tij, në bashkëpunim me qeverinë do bëhet e mundur edhe sigurimi i një financimi për të ndërtuar edhe një pallat tjetër në banesa sociale, ku mund të strehohen familjet e tjera që preken nga zbatimet e projektit të Unazës së Madhe.

AKUZA
Teksa qëndronte pranë protestuesve, ku dha edhe mesazhin e festës së flamurit, që është uniteti, deputetja Albana Vokshi tha se ata që u paraqitën në takim ishin policë bashkiakë dhe punonjës të administratës. Vokshi publikoi një foto, sipas së cilës persona janë policë bashkiakë dhe jo banorë.



Dhuna në protestë, Avokati i Popullit: Hetim, do këqyren pamjet filmike

Institucioni i Avokatit të Popullit reagoi në lidhje me protestat e banorëve që preken nga projekti i Unazës së Re. Referuar rastit të Daniel Drobajt, i cili akuzohet se hodhi kapsolla në drejtim të efektives Ina Nuka, institucioni i Avokatit të Popullit shprehet se po merren pamjet filmike për të parë nëse është ushtruar dhunë ndaj tij apo jo. "Pasi janë përpiluar procesverbale, të cilat janë nënshkruar prej të miturve të ndaluar, është vazhduar me hetimin. Për të bërë një hetim administrativ të plotë, objektivi dhe profesional nga Avokati i Popullit në datën 27.11.2018 i është bërë kërkesë Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë për ekspertimin mjekoligjor të të dy shtetasve P.A. dhe D.D. Ndërkohë po në datën 27.11.2018 i është bërë një kërkesë DVP Tiranë për dërgimin e një CD-je me pamjet filmike të regjistruara nga sistemi i monitorimit të DVP Tiranë, duke përfshirë edhe filmimet në oborrin dhe korridorin e godinës së këtij organi", thuhet në njoftim.

HETIMI
"Sipas Drobajt, edhe gjatë rrugës, në makinën e policisë dhe në momentin që e kanë zbritur nga automjeti në oborrin e DVP Tiranë ishte dhunuar nga policët, duke u goditur me grushte dhe shpulla në kokë e në trup, por sipas tij nuk kishte asnjë gjurmë të dukshme për shkak të profesionalizmit të tyre", thuhet në reagimin e AP.

LEGALIZIMET PROJEKTLIGJI

Qytetarët që kanë një kontratë parablerjeje mund ta regjistrojnë vetë apartamentin

Nisma, ja si veprohet me objektet kur ndërtuesi ka falimentuar

Qeveria do nxjerrë udhëzim për procedura të veçanta

Periodha e gjatë e tranzicionit në Shqipëri ka sjellë dhe shumë raste kur ndërtues të ndryshëm pasi kanë mashtruar blerësit dhe u kanë marrë lekët janë larguar duke mos i përfunduar ndërtimet të cilat i kanë lënë karabina. Për shkak edhe të një vakumi ligjor kjo ka sjellë që shumë qytetarë të mos e gjejnë dot ende të drejtën e tyre, ndërsa prona ka mbetur e pazhvilluar dhe tashmë e amortizuar. Pikërisht për t'i dhënë zgjidhje kësaj kategorie, qeveria në projektligjin "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësive në Republikën e Shqipërisë", i ka dedikuar disa dispozita të veçanta që trajtojnë pikërisht rastet kur ndërtuesit apo sipërmarrësit kanë shpallur falimentin, nuk kanë përfunduar objektin apo edhe nuk kanë ndjekur procedurat për ta legalizuar objektin.

Falimenti

Më konkretisht për ndërtimet pa leje, që kategorizohen si objekte me shkelje të lejes së ndërtimit, kur subjektet ndërtuese apo investitorë janë në kushtet e nenit 99, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pra kanë falimentuar apo nuk plotësojnë detyrimet që burojnë nga ky ligj, duke braktisur procesin legalizues, miratimi i legalizimit kryhet për poseduesit e ndërtimit që kanë hyrë në marrëdhënie kontraktore me ta. Thënë ndryshe të gjithë qytetarët që kanë një kontratë parablerjeje me një ndërtues që ka falimentuar apo ka braktisur objektin, atëherë ata mund ta vazhdojnë vetë procesin e zhvillimit të objektit dhe të legalizimit të tij. Detyrimet për pagesat, në zbatim të këtij ligji, dhe detyrimet tatimore, që i janë ngarkuar subjektit ndërtues, nuk pengojnë legalizimin në favor të poseduesve. Agjencia Shqiptare e Kadastrës si institucioni i ri që do të merret me procesin e legalizimit dhe hipotekimit ka për detyrë t'i dërgojë njësisë të vetëqeverisjes vendore listën e subjekteve zhvillues/investitorë, të cilët kanë shkëlur kushtet e lejes së ndërtimit apo nuk ndjekin procedurat e legalizimit, me qëllim evidentimin e tyre si subjekte me risk në keqmenaxhimin e territorit.

PROCEDURA

Ndërkohë që procedurat e veçanta të legalizimit në favor të poseduesve, sipas këtij parashikimi, si dhe rregullat për përfundimin e procedurës nga subjektet



Gjatë një mbledhjeje të qeverisë

RASTET E FALIMENTIT

Për ndërtimet pa leje, që kategorizohen si objekte me shkelje të lejes së ndërtimit, kur subjektet ndërtuese apo investitori ka falimentuar apo nuk plotësojnë detyrimet që burojnë nga ky ligj, duke braktisur procesin legalizues, miratimi i legalizimit kryhet për poseduesit e ndërtimit që kanë hyrë në marrëdhënie kontraktore me ta.

Programe sociale strehimi për ata që do u prishen shtëpitë

Të gjitha ato objekte që për shkak të kriterëve përjashtues nuk do arrijnë dot as me këtë ligj të legalizohen do të prishen nga Inspektorati Ndërtimor. Por ndryshe nga më parë, ku ligji nuk parashikonte një zgjidhje për ata që mbeteshin pa një banesë, projektligji i parqitur për diskutim detyron pushtetin vendor që t'i trajtojë qytetarët apo familjet që do u prishen shtëpitë me programe sociale strehimi. Kështu, kur poseduesit e ndërtimeve pa leje (banesa), që përjashtohen nga legalizimi, kur nuk zotërojnë objekt tjetër pa leje apo edhe të ligjshëm, trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në përputhje me dokumentet e miratuara të planifikimit të territorit dhe legjislacionin për programet sociale të strehimit. Për zbatimin e kësaj dispozite, Agjencia Shtetërore e Kadastrës i përcjell njësisë së vetëqeverisjes vendore listën e subjekteve dhe praktikant dokumentare të ndërtimeve që përjashtohen nga legalizimi. Rregullat e bashkërdimit të punës ndërmjet ASHK-së dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore, për trajtimin e ndërtimeve pa leje që përjashtohen nga legalizimi, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



ose shoqëritë ndërtuese, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Pra, nisur nga fakti se bëhet fjalë për një kategori krejt të

veçantë, procedurat konkrete të detajuara të legalizimit të këtyre lloj objekteve do të përcaktohen me vendim të qeverisë.

NDËRTIMET E NGRITURA NGA PERSONAT JURIDIKË NË PROCES FALIMENTIMI

■ NENI 27

1. Për ndërtimet pa leje, që kategorizohen si objekte me shkelje të lejes së ndërtimit, kur subjektet ndërtuese/investitorë janë në kushtet e nenit 99, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar, apo nuk plotësojnë detyrimet që burojnë nga ky ligj, duke braktisur procesin legalizues, miratimi i legalizimit kryhet për poseduesit e ndërtimit që kanë hyrë në marrëdhënie kontraktore me ta.
2. Detyrimet për pagesat, në zbatim të këtij ligji, dhe detyrimet tatimore, që i ngarkohen subjektit ndërtues, nuk pengojnë legalizimin në favor të poseduesve dhe nuk shuhen, por mbledhen nga organet tatimore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
3. ASHK-ja u dërgon njësisë të vetëqeverisjes vendore listën e subjekteve zhvillues/investitorë, të cilët kanë shkëlur kushtet e lejes së ndërtimit apo nuk ndjekin procedurat e legalizimit, me qëllim evidentimin e tyre si subjekte me risk në keqmenaxhimin e territorit.
4. Procedurat e veçanta të legalizimit në favor të poseduesve, sipas këtij neni, si dhe rregullat për përfundimin e procedurës nga subjektet dhe/ose shoqëritë ndërtuese/investitore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Foto ilustruese



Hapet procesi edhe për shtesat pa leje në pallatet me leje

Nisma ligjore që ka paraqitur qeveria krijon mundësi për të vijuar procesin e legalizimit edhe objektet apo shtesat e bëra në objekte me leje. Pra, thënë ndryshe do të lejohet legalizimi i shtesave anësore apo ato të ngritura në nivel në një objekt apo ndërtim përtej parashikimeve që bënë leja e ndërtimit. Kështu nëse ndërtimi është i llojit "objekt me shkelje të lejes së ndërtimit", pavarësisht gjendjes juridike të pronësive së truallit ku ngrihet, trajtohet njësoj si objektet e tjera që mund të legalizohen. Ndërsa për ndërtimet pa leje, që nuk janë deklaruar me formë, poseduesit kanë të drejtë të aplikojnë për legalizim sipas rregullave që duhet të përcaktohen me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së. Aplikimet për legalizim, të administruara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, që kanë mangësi të elementeve të formës, konsiderohen të vlefshme dhe ndërtimet pa leje, të deklaruara nëpërmjet tyre, shqyrtohen sipas kushteve të këtij ligji.



VENDIMET E PAMIRATUARA

Për ndërtimet e legalizuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të cilat nuk është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave për kalimin e së drejtës së pronësisë të parcelës ndërtimore, titulli i pronësisë mbi truallin apo mbi pjesën takuese konsiderohet i fituar sipas lejes së legalizimit. Rregullat e parashikuara në pikat 5 deri në 12, të nenit 19, të këtij ligji, zbatohen edhe për këto raste.



TRAJTIMI ME PËRPARËSI

Ndërtimet pa leje, që gjenden në territoret e zonave informale, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk janë legalizuar ende, trajtohen me përparësi. Këshilli i Ministrave, në vendimin që miraton sipas nenit 13, të këtij ligji, parashikon kriteret të posaçme lehtësuese të legalizimit për këtë kategori ndërtimesh.

Do hapen aplikimet për objektet pa leje të bëra në pronën tënde ose shtet

Shtyhet afati, legalizohen ndërtimet e bëra deri në 31 dhjetor 2018

Nisma përjashton godinat e bëra në tokën e tjetrit

PROJEKTLIGJI


NENI 67

1. Procedurat dhe kriteret e ligjësisimit, sipas kreut III, zbatohen për ndërtimet pa leje që evidentohen në ortofoton e realizuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, në kuadër të projektit "Krijimi i sistemit të të dhënave gjeohapësinore", të autoritetit shtetëror përgjegjës për informacionin gjeohapësinor (ASIG).
2. Për ndërtimet pa leje, që nuk evidentohen në fotografimin ajror, por janë ndërtuar deri në datën 31.12.2018, veçohet, si më poshtë vijon:
 - a) Nëse janë ndërtuar mbi tokë në pronësi të poseduesit apo mbi tokë, për të cilën është miratuar më parë kalimi i pronësisë me VKM, në bazë të nenit 17, të ligjit nr.9402/2006, të ndryshuar, trajtohen sipas kreut III, të këtij ligji;
 - b) Nëse janë ndërtuar mbi tokë në pronësi të shtetit apo të njësitve të vetëqeverisjes vendore, përdoren nga poseduesit e tyre deri në momentin e shfrytëzimit të tokës, sipas dokumenteve të planifikimit të territorit ose vendimmarrjes së organeve shtetërore kompetente;
 - c) Nëse janë ndërtuar mbi tokë në pronësi private të të tretëve, prishen sipas dispozitave ligjore për inspektimin e ndërtimit;
 - d) Nëse ndërtimi është i llojit "objekt me shkelje të lejes së ndërtimit", pavarësisht gjendjes juridike të pronësisë së truallit ku ngrihet, trajtohet sipas kreut III, të këtij ligji.
3. Për ndërtimet pa leje, që nuk janë deklaruar më parë, poseduesit kanë të drejtë të aplikojnë për legalizim sipas rregullave që përcaktohen me udhëzime të drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së.
4. Aplikimet për legalizim, të administruara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, që kanë mangësi të elementeve të formës, konsiderohen të vlefshme dhe ndërtimet pa leje, të deklaruara nëpërmjet tyre, shqyrtohen sipas kushteve të këtij ligji.
5. Për ndërtimet e legalizuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të cilat nuk është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave për kalimin e së drejtës së pronësisë të parcelës ndërtimore, titulli i pronësisë mbi truallin apo mbi pjesën takuese konsiderohet i fituar sipas lejes së legalizimit. Rregullat e parashikuara në pikat 5 deri në 12, të nenit 19, të këtij ligji, zbatohen edhe për këto raste.
6. Vendimet e Këshillit të Ministrave për kalimin e pronësisë mbi parcelën ndërtimore dhe/ose për kompensimin e pronarëve jo posedues, të miratuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, iu nënshtruan ndryshimeve kur janë pranishme shkaqet ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. ASHK-ja harton dhe i paraqet Këshillit të Ministrave projektvendimet përkatëse.
7. Ndërtimet pa leje, që gjenden në territoret e zonave informale, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk janë legalizuar ende, trajtohen me përparësi. Këshilli i Ministrave, në vendimin që miraton sipas nenit 13, të këtij ligji, parashikon kriteret të posaçme lehtësuese të legalizimit për këtë kategori ndërtimesh.
8. Aplikimet e administruara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji për objektet pa titull pronësie dhe tjetër të tyre funksionale si dhe për oborret në përdorim, për të cilat nuk është përfunduar procedimi administrativ, shqyrtohen sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj.
9. Për të gjitha subjektet, që përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë përfutur kalimin e pronësisë mbi objektet pa titull pronësie, tjetër e tyre funksionale dhe oborret në përdorim, por nuk kanë shlyer pagesën e truallit, kjo pagesë falet. Përjashtim bëjnë rastet kur truallit funksional ose oborri në përdorim është në pronësi të të tretëve. Në këto raste, kur pagesa nuk është shlyer, detyrimi financiar rillogarit në bazë të parashikimeve të pikës 4, të nenit 30, të këtij ligji.

Nëse ke ndërtuar pa leje në një tokë që është pronë e jotja apo pronë shtetërore mund ta legalizosh sërish, pavarësisht faktit nëse e ke ndërtuar edhe gjatë këtyre ditëve të fundit. Qeveria ka parqitur në Kuvend projektligjin "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", ku i kushton një kapitull të veçantë edhe ndërtimeve pa leje. E ndërta në kapitullin III përcakton të gjithë procedurën që duhet të ndiqet për ndërtimet e bëra pa leje, në dispozitat kalimtare, ky projektligji parashikon edhe se si do të veprohet me ndërtimet pa leje që evidentohen nga fotografimi i hapësirë para hyrjes në fuqi të këtij ligji apo edhe ato që nuk janë evidentuar në të, por që janë ndërtuar deri në 31 dhjetor 2018. Ky, në fakt, përbën një shtyrje të afatit që përcakton ligji për legalizimet, i cili ka caktuar si afat të fundit të objekteve pa leje që mund të hyjnë në proces legalizimi pikërisht ato që janë ndërtuar deri në 27 qershor të vitit 2014. Pra, me këtë sanksionim që bënë projektligji i paraqitur në Kuvend i hapet rruga e legalizimit të të gjitha ndërtimeve apo shtesave pa leje që janë ndërtuar në tokën tënde apo në tokë shtetërore. Përjashtohen nga ky proces vetëm ndërtimet apo shtesat që janë bërë në tokë private të të tjerëve.

PROCEDURA

Procedurat dhe kriteret e ligjësisimit, që përcakton kreut III i këtij projektligji dhe që flet pikërisht me legalizimin e ndërtimeve pa leje, zbatohen edhe për ndërtimet pa leje që evidentohen në ortofoton e realizuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, në kuadër të projektit



AFATI

Në dispozitat kalimtare ky projektligji parashikon edhe se si do të veprohet me ndërtimet pa leje që evidentohen nga fotografimi i hapësirë para hyrjes në fuqi të këtij ligji apo edhe ato që nuk janë evidentuar në të, por që janë ndërtuar deri në 31 dhjetor 2018.

Ligji ekzistues i legalizimeve vendosi si afat qershorin e 2014

Në vitin 2014, vetëm një vit pasi kishin ardhur në pushtet, socialistët miratuan disa ndryshime të rëndësishme në ligjin për legalizimet, ku ndërmjet të tjerave parashikohej që t'i jepej fund procesit të ndërtimeve pa leje në Shqipëri. Kështu, një nga ndryshimet e rëndësishme që u bë ishte vendosja e datës 27 qershor 2014 si kufi fundor, brenda të cilit të gjitha ndërtimet e bëra pa leje mund të legalizoheshin, mjaftonte vetëm të plotësonin kriteret ligjore. "Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar; përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj", përcakton neni 2 i ligjit për legalizimet që është ende në fuqi. Për të gjitha ndërtimet e bëra pas kësaj date, ligji parashikon moslegalizimin e tyre dhe prishjen nga Inspektorati Ndërtimor:

"Krijimi i sistemit të të dhënave gjeohapësinore", të autoritetit shtetëror përgjegjës për informacionin gjeohapësinor (ASIG). Ndërkohë që për ndërtimet pa leje, që nuk evidentohen në fotografimin ajror, por janë

ndërtuar deri në datën 31.12.2018, veprohet, ky projektligj përcakton se, nëse ato janë ndërtuar mbi tokë në pronësi të poseduesit apo mbi tokë, për të cilën është miratuar më parë kalimi i pronësisë me VKM, trajtohen pikërisht sipas kriterëve që parashikon kreu III i këtij projektligji, duke parë së pari, kriteret përjashtuese. Kujtojmë se te kriteret përjashtuese është vendosur pikërisht që një ndërtim pa leje të mos jetë ndërtuar pranë apo në gjurmë e veprave kryesore të infrastrukturës publike, akteve rrugore kombëtare, territorit apo funksionalitetit të ndërtesave publike, apo kur ato prekin apo cenojnë integritetin e monumenteve të kulturës, territoret e destinuara për investime strategjike apo janë në vijë bregdetare. Pra, në rast se nuk një ndërtim i kësaj kategorije nuk cenon këto kriteret ai hyn në proces legalizimi sipas këtij projektligji. Gjithashtu, në proces legalizimi mund të hyjnë edhe ndërtimet pa leje janë bërë mbi tokë në pronësi të shtetit apo të njësitve të vetëqeverisjes vendore dhe që deri në këtë moment përdoren nga poseduesit e tyre.

NDËRTESAT QË PRISHEN

Projektligji parashikon edhe rastet e ndërtimeve pa titull pronësie të cilat mund të përfshihen në proces legalizimi. Kështu përveç kriterëve të mësipërme kjo nismë ligjore kërkon të sanksionojë se nuk mund të legalizohen ndërtimet e reja pa leje që janë ndërtuar në tokë private të tjerëve. "Nëse janë ndërtuar mbi tokë në pronësi private të të tretëve, prishen sipas dispozitave ligjore për inspektimin e ndërtimit", thuhet në nenin 67 të projektligjit.

Prokuroria: Sasia e madhe e drogës kishte destinacion përfundimtar Gjermaninë

TIRANË

Afro një vit pas trafikimit të sasisë prej 2.5 tonë kanabis nga Shqipëria në Itali dhe me destinacion përfundimtar Gjermaninë, Prokuroria e Krimeve të Rënda ka dërguar për gjykim 9 persona të pandehur në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Kamioni me sasinë e madhe të drogës u kap në janar të vitit që shkoi në Ankona të Italisë. Mjeti u kontrollua dhe u bllokua për mungesë dokumentacioni, por më pas rezultoi se ai kishte një sasi gjigande kanabisi që po transportohej. Nga hetimet e prokurorisë ka rezultuar se kamioni tip 'Benz', me targa të kokës 'FR 9139 C' dhe targa trajleri 'ARB 414', i ngarkuar me sasinë e drogës ishte nisur nga porti i Durrësit dhe kishte si drejtues shtetasin shqiptar Dhimo Koraj. Lënda narkotike ishte fshehur në mallin drusor pelet, ndërsa pritësi i saj ishte Euron Hoti.

NJOFTIMI I PROKURORISË

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka përfunduar çështjen penale nr. 12/3 të vitit 2017 në ngarkim të të pandehurve:

1. Emiljano Çili lindur më 11 shtator 1982 në Poliçan, Skrapar, kombësi dhe shtetësi shqiptar, banues në Tiranë, me gjendje gjyqësore i padënuar, i hetuar me masën e sigurimit arrest në burg në mungesë, i akuzuar për kryerjen e veprave penale "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/1, 334/1 të Kodit Penal;

2. Artur Riza lindur më 19 shkurt 1976 në Thumanë, Krujë, kombësi dhe shtetësi shqiptar, banues në Tiranë, me gjendje gjyqësore i padënuar, i hetuar me masën e sigurimit arrest në burg në mungesë,

i akuzuar për kryerjen e veprave penale "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", "Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit", në bashkëpunim, parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/1, 334/1 dhe 109/1, 25 të Kodit Penal;

3. Festim Lelaj, lindur më 17 shtator 1970 në Mesapllk, Vlorë, kombësi dhe shtetësi shqiptar, banues në Tiranë, me gjendje gjyqësore i padënuar, i hetuar në fillim me masën e sigurimit arrest në burg, zëvendësuar më pas me masën e sigurimit "arrest në shtëpi".

i akuzuar për kryerjen e veprave penale "Trafikimi i

Kamioni me 2.5 tonë kanabis sativa, dërgohet për gjykim 9 trafikantët

Lënda narkotike e nisur nga porti i Durrësit u kap në janar të 2017-ës në Ankona të Italisë



Droga e sekuestruar në Ankona të Italisë

narkotikëve", në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/1, 334/1 të Kodit Penal;

4. Harmejllindo Tufta, lindur më 6 shkurt 1995 në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptar, banues në Tiranë, me gjendje gjyqësore i padënuar, i hetuar me masën e sigurimit arrest në burg në mungesë,

i akuzuar për kryerjen e veprave penale "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal;

5. Juri Bedinaj, lindur më 4 nëntor 1988, lindur dhe banues në Vlorë, me kombësi dhe shtetësi shqiptar, me gjendje gjyqësore i padënuar, i hetuar me masën e sigurimit arrest në burg në mungesë, i akuzuar për kryerjen e veprave penale "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal;

6. Arbi Mustafa, lindur më 25 tetor 1983, lindur dhe banues në Vlorë, me kombësi dhe shtetësi shqiptar, me

gjendje gjyqësore i padënuar, i akuzuar për kryerjen e veprave penale "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal, i hetuar me masën e sigurimit arrest në burg,

7. Adjel Çaušhaj lindur më 15 gusht 1995, lindur dhe banues në Vlorë, me kombësi dhe shtetësi shqiptar, me gjendje familjare beqar, me gjendje gjyqësore i padënuar, i akuzuar për kryerjen e veprave penale "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuara nga nenet 186/2 të Kodit Penal.

Me datë 03.01.2017 nga Pika e Kalimit Kufitar Porti Durrës ka dalë për në drejtim të Portit të Ankonës Itali, kamioni tip 'Benz', me targa të kokës 'FR 9139 C' dhe targa trajleri 'ARB 414', i ngarkuar me sasinë e lëndës narko-

tike prej 2 tonë e 530 kg, me drejtues shtetasin shqiptar Dhimo Koraj, i cili po e trafikonte lëndën narkotike nga Shqipëria duke e kaluar transit në Itali dhe me destinacion përfundimtar në Gjermani, ku pritësi i saj ishte shtetasi Euron Hoti.

Lënda narkotike është fshehur në mallin drusor pelet, që sipas dokumentacionit shoqëruar të paraqitur ishte marrë tek shoqëria AL MEXWOOD SHPK-Grmash-Shqipëri dhe që do të ekspostohej nëpërmjet shoqërisë së transportit ALPIROS GROUP 2007-FIER-Shqipëri, në drejtim të porositësit, në adresën e shtetasit Euron Hoti, me gjenralitetet të falsifikuara, ARTAN ABAZI, me adresë A/M SCHAART 127809LEMWERGER-GJERMANI.

Me datë 04.01.2017, nga autoritetet Italiane është bllokua për mungesë dokumentacioni transiti ndërkombëtar automjeti kamion tip 'Benz', me targa të kokës 'FR 9139 C' dhe targa trajleri 'ARB 414', me drejtues shtetasin shqiptar Dhimo Koraj.

Në saj të informacioneve të marra në rrugë operative në rrugën "Sadik Petrela" u bë ndalimi i mjetit, me të cilin ky shtetas po lëvizte. Gjatë kontrollit u gjetën 20.500 euro të dyshuara të falsifikuara, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale bashkë me mjetin dhe dy aparate celular. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të operacionit të koduar "500", arrestuan G. Xh., 37 vjeç, banues në Kavajë.



Sekuestrohen 20 mijë euro të falsifikuara, përfundon në pranga 37-vjeçari nga Kavaja

TIRANË - Një 37-vjeçar nga Kavaja është arrestuar dhe në flagrancë nga policia e Tiranës, pasi akuzohet për veprat penale: "Falsifikimi i monedhave" dhe "Riprodhimi pa të drejtë i kamionit së tjetrit". Burime nga policia bënë me dije se Seksioni për Krimin Ekonomik dhe Financiar, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të operacionit të koduar "500", arrestuan G. Xh., 37 vjeç, banues në Kavajë.

Në saj të informacioneve të marra në rrugë operative në rrugën "Sadik Petrela" u bë ndalimi i mjetit, me të cilin ky shtetas po lëvizte. Gjatë kontrollit u gjetën 20.500 euro të dyshuara të falsifikuara, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale bashkë me mjetin dhe dy aparate celular. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të operacionit të koduar "500", arrestuan G. Xh., 37 vjeç, banues në Kavajë.



Plagosi të riun dhe grabiti makinën, kapet 29-vjeçari

PRRENJAS - Policia ka prangosur në kohë rekord një 29-vjeçar nga Përrenjasi, i cili ka plagosur me armë një të ri dhe më pas ka grabitur me forcë makinën në tentativë për t'u larguar nga vendi i krimit. Ngjarja ndodhi në orët e para të mëngjesit të djeshëm në një lokal në fshatin Kakavec. Sipas bluve, Afrim Radiçi, pas një konflikti të castit për motive të dobëta ka plagosur me pistoletë shtetasin Xh.P., 23 vjeç, banues në Kakavec. "Falë reagimit të shpejtë e profesional të policisë, kapet në kohë reale autori i plagosjes me armë të 22-vjeçarit. Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar arma e zjarrit pistoletë tip "Zantava" me 3 fishekë, si dhe automjeti i vjedhur. Më datë 28.11.2018, rreth orës 01:30, në një lokal në fshatin Kakavec, Përrenjas, shtetasi Afrim Radiçi, pas një konflikti të castit për motive të dobëta ka plagosur me armë zjarri pistoletë shtetasin Xh.P., 23 vjeç, banues në Kakavec, i cili është transportuar në spitalin e Librazhdit dhe është jashtë rrezikut për jetën. Shtetasi Afrim Radiçi në tentativë për t'u larguar nga vendi i ngjarjes ka dalë në rrugë dhe nën kërcënimin e armës ka ndaluar mjetin tip "Golf" në pronësi të shtetasit A.B., të cilin e ka marrë dhe është larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes. Falë reagimit të shpejtë të policisë Librazhdit dhe mirënjohimit të punës u bë e mundur që rreth 60 km nga vendi i ngjarjes, në fshatin Dorez, të kapej shtetasi Afrim Radiçi, autori i dyshuar i dy ngjarjeve, plagosjes me armë të 22-vjeçarit si dhe të rrëmbimit të automjetit nën kërcënimin e armës. Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar arma e krimit si dhe automjeti tip "Golf". Grupi hetimor vijon punën për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të kësaj ngjarje", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Sherri para lokalit "Monopol", dyshohet për prishje pazaresh për një ngarkesë droge

Masakra me 1 të vrarë e 2 të plagosur në ish-Bllok, në kërkim biznesmeni Eldi Dizdari

Kushëriri i Arbër Çekajt të 613 kg kokaine u konfliktua me Ervin Matën para përplasjes me armë

TIRANË

Hetimet e kryera nga policia dhe prokuroria në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur më 4 tetor të këtij viti në zonën e ish-Bllokut, ku mbeti i vrarë 28-vjeçari Fabian Gaxha dhe u plagosën Ervis Martinaj e Eljon Hato kanë nxjerrë në "skenë" një tjetër person. Bëhet fjalë për biznesmenin Eldi Dizdari, i cili është shpallur në kërkim nga policia. Ndonëse pas ngjarjes në lokalit "Monopol", këngëtarja e njohur Elvana Gjata u konsiderua si mollë shërri, zanafilla e saj duket të jetë kreu tjetër. Ngjarja dyshohet të ketë si shkak prishjen e pazareve të drogës mes Ervin Matës (të fejuarin e këngëtares Gjata) dhe biznesmenit Eldi Dizdari, që dyshohet të jetë personi kyç i kësaj ngjarjeje. Sipas burimeve nga prokuroria, mësohet se Dizdari ka qenë i pari që është konfliktuar me Ervin Matën dhe kushëririn e Elvana Gjatës, Merviol Bilo. Dyshohet se Mata dhe Dizdari janë konfliktuar për çështjen e një borxhi financiar, borxh i cili nuk ishte shlyer nga Ervin Mata. Grupi hetimor kërkon të marrë dëshminë e biznesmenit Eldi Dizdari për të ndërtuar saktë dinamiken dhe motivin e ngjarjes që përfundoi me një të vrarë dhe dy të plagosur. Eldi Dizdari, i njohur ndryshe dhe me emrin Denis Matoshi është kushëriri i Arbër Çekajt, pronarit të kompanisë së bananeve që është arrestuar në Gjermani për trafikun e sasisë prej 613 kg kokainë, që u sekuestrua para disa muajsh në Durrës.


HETIMET DHE I KËRKUARI DIZDARI

Në dosjen e Prokurorisë së Tiranës, ku jepet i gjithë dinamika e ngjarjes në zonën e ish-Bllokut, thuhet se ndërsa ishte në lokalit "Monopol" në zonën e Bllokut, Ervin Mata ka dalë jashtë për t'u takuar me të fejuarën e tij, shtetasen Elvana Gjata, për të shkëmbyer një çelës shtëpie. Ajo e kishte parkuar automjetin e saj në rresht për dy. Në momentin që Ervini ka qenë duke bashkëbiseduar me të fejuarën, në rresht të tretë, ka kaluar një automjet, në të cilin dyshohet të ketë qenë biznesmeni Eldi Dizdari, që ka komunikuar në distancë me Matën. Ky automjet ka vazhduar qarkullimin dhe për një moment ndalon dhe kryen manovrën e ecjes mbprapa dhe pasi qëndron aty afrohet shtetasja Ervin Mata, pamje të cilat janë regjistruar nga DVR e një subjekti privat.

Sipas informacioneve të reja të ardhura në Prokurori nga shërbimet partnere, rezultojnë se Mata nuk i është përgjigjur Dizdarit për një ngarkesë të



Ervin Mata



Eldi Dizdari

KUSH ËSHTË ELDI DIZDARI

Eldi Dizdari, i njohur ndryshe dhe me emrin Denis Matoshi është kushëriri i Arbër Çekajt, pronarit të kompanisë së bananeve që është arrestuar në Gjermani për trafikun e sasisë prej 613 kg kokainë, që u sekuestrua para disa muajsh në Durrës. Biznesmeni Dizdari është bashkëshorti i vajzës së njohur të ekranit, Suada Sherifi, e kurorëzuar "Miss Shqipëria" disa vite më parë. Nga lidhja e tyre ka ardhur në jetë vajza, me emrin Deji.

Masakra te "Monopol", këngëtarja sështë në kërkim policor

Elvana Gjata, letër prokurorisë: Jam në Gjermani për arsye shëndetësore, dëshmoj kur të kthehem

TIRANË - Afro dy muaj nga ngjarja e rëndë në ish-Bllok, këngëtarja e njohur shqiptare, Elvana Gjata nuk është më në kërkim policor. Mësohet se ka përfunduar afati prej 30 ditësh ku Gjata ishte në kërkim në lidhje me vrasjen në lokalit "Monopol". Dy ditë më parë, burime për "GSH" bënë me dije se njoftimi për Gjatën është dërguar në të gjitha pikat kufitare dhe nëse këngëtarja paraqitet aty, ajo do të shoqërohet për t'u marrë në pyetje. Ajo u shpall në kërkim më 9 tetor, ndërsa prokuroria urdhëroi shoqërimin e detyrueshëm të këngëtares, e cila ishte në lokalin ku ndodhi ngjarja vetëm 20 minuta para krimin. Shpallja në kërkim policor e detyronte Gjatën që të paraqitej për të dhënë shpjegime brenda 30 ditëve, pasi duhej të jepte deklaratim e saj për ngjar-



jen. Por kjo gjë nuk ka ndodhur. Ndërkaq, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me komunikimin e Elvana Gjatës me grupin hetimor. Burime për "Report TV" pohuan se tri javë më parë Elvana Gjata ka thyer heshtjen përmes një letre, e cila përmban kode postare të Gjermanisë drejtuar Prokurorisë së Tiranës, por detajet janë bërë publike vetëm ditën e djeshme. Drej-

konsiderueshme droge, gjë që e ka tensionuar raportet me tyre. Ka qenë Dizdari, që i ka thënë Matës se për borx-

hin duhet të sqarohet me Ervis Martinaj. Në këtë konflikt është përpjekur të hyjë dhe komandoja Merviol

tuar organit të akuzës, këngëtarja i njoftojnë se ndodhet jashtë Shqipërisë për arsye shëndetësore, ndërsa shton se është njoftuar nga mediat lidhur me faktin se prokuroria kërkon dëshminë e saj për rrethanat e asaj që ndodhi brenda lokalit "Monopol", edhe pse thekson se nuk ka qenë e pranishme në momentin kur nisi konfliktin me armë. "Ndodhem jashtë vendit për arsye shëndetësore, jam njohur nga media se kërkoni dëshminë time. Sapo të jem në Shqipëri, do të paraqitem për të dhënë deklaratim e mia", ka shkruar Elvana. Edhe sipas hetimeve të policisë dhe Prokurorisë rezultojnë se këngëtarja s'ka qenë e pranishme në momentet e konfliktit në ish-Bllok, ku nga përplasje fizike dhe përdorimi i armëve mbeti një i vrarë dhe dy të plagosur.

Bilo, por nga pamjet filmike ka rezultuar se Bilo largohet nga Mata dhe më pas Eldi Dizdari së bashku me

personat e tjerë që ishin me të janë larguar. Makina e tyre është ndjekur në këmbë nga Mata dhe grupi i tij deri tek zona e "Sky Tower", por nuk kanë mundur më ta shikojnë dhe janë rikthyer sërish pas, duke u futur në lokal "Monopol". Ndërkohë, Dizdari nuk ka qenë fizikisht në lokalit "Monopol", aty ku ndodhi dhe përleshja fizike dhe me armë, pasi është larguar në drejtim të pacaktuar ende. Pamjet filmike të disa bizneseve sipas prokurorisë kanë zbuluar se Dizdari ka qenë personi i parë ai që është konfliktuar me Ervin Matën dhe më pas është larguar. Pas këtij momenti, pronari i lokalit "Monopol", Redi Popesku thotë se biznesmeni Mata i ka kërkuar leje për të sjellë brenda në lokal Ervis Martinajin, i cili është ulur më pas në banak me persona të tjerë, ku nuk ka vonuar shumë dhe ka nisur konfliktin, i cili degjeneroi në përdorimin e armëve. Si pasojë e të shtënave në lokal humbi jetën 28-vjeçari Fabian Gaxha, ndërsa u plagosën dy të tjerë, Ervis Martinaj dhe Eljon Hato (të dy të arrestuar). Ndërsa vijojnë të jenë në kërkim për këtë ngjarje shtetasit: Merviol Bilo, Ervin Mata, Fabiol Alushi dhe së fundi edhe biznesmeni Eldi Dizdari. Ndërkohë, këngëtarja Elvana Gjata nuk është më në kërkim policor, pas përfundimit të afatit 30-ditor.

SHKURT

Sekuestrohen 394 gr kokainë, kapet i riu, një tjetër në kërkim
POGRADEC - Policia e Pogradecit ka sekuestruar dje 394 gr kokainë, ndërsa ka përfunduar në pranga një i ri dhe një tjetër është shpallur në kërkim. Sipas bluve, në pranga ka rënë Jurgen Papa, 24 vjeç, banues në këtë qytet. Kurse shtetasi i shpallur në kërkim është

A.P. 26 vjeç, banues në Pogradec. Mësohet se Jurgen Papa së bashku me shtetasin A.P., qëlluan me armë zjarri në ajër. Policia gjithashtu sekuestroi 1 krehër pistolette me 9 fishekë. Ndërkohë, policia së bashku me grupin hetimor kanë nisur hetimet për dokumentimin e plotë të këtij rasti si dhe arrestimin e të kërkuarit.

Masat, sekuestrohen lëndë plasëse në dy dyqane

TIRANË - Një ditë pasi Ministria e Brendshme paralajmëroi masa të ashpra për subjektet që tregtojnë kapsolla dhe fishekzjarrë, policia ka gjetur dhe sekuestruar materiale piroteknike me rrezikshmëri të lartë në dy subjekte. Pronarët e tyre u referuan në prokurori për tregtim të lëndëve piroteknike jashtë kushteve dhe kriterëve, ndërsa dyqanet nuk do të mbylleen. "Pas kontrolleve janë konstatuar dy subjekte (dyqane) që mbanin dhe tregtonin lëndë piroteknike në mospërputhje me kushtet dhe kriteret për mënyrën e magazinimit dhe përdorimit të lëndëve piroteknike. Policia ka sekuestruar në cilësinë e provës materiale lëndën plasëse dhe piroteknike, ndërsa ndaj dy pronarëve të dyqaneve janë marrë masa të menjëhershme. Kontrollat do vijojnë edhe në ditët në vijim në gjithë dyqanet dhe tregjet e qarkut Tiranë", njofton policia.


U kap në Kakavijë me pasaporte false, ja për çfarë akuzohet

Lirohet nga qelia i forti i Shkodrës, Lulzim Kulla

10 muaj më parë i vunë në makinë 500 gramë tritol

GJIROKASTER

Gjykata e Gjirokastrës ka liruar nga burgu biznesmenin shkodran, Lulzim Kulla, i njohur për atentatin me tritol që iu bë 10 muaj më parë. Sipas burimeve ai vuan nga një sëmundje e rëndë e pas ditëve të plotësuar në parburgim i kish mbetur shumë pak dënim. Lajmi për lirimin e Kullës e konfirmon avokati i tij Detar Hysi. Sipas avokatit, nuk provohet fajësia ndaj klientit të tij. Kujtojmë se Kulla u arrestua pasi u kap në pikën kufitare të Kakavijës me një pasaportë të falsifikuar në tentativë për të ikur në Greqi. Kulla rezultoi se në korrik të vitit 2014 është pajisur me një pasaportë me të dhëna të falsifikuara. 43-vjeçari ka aplikuar me shenjat e gishtërinjve dhe fotografinë e tij, por me emrin Alfons Deda, për pasaportë në Durrës, duke përdorur kështu identitetin e një personi tjetër. Pasi ka tërhequr pasaportën, nga verifikimet e kryera ka rezultuar se të dhënat e tij nuk përkojnë me identitetin e dhënë. Kulla u vu në qendër të vëmendjes së publikut në janar të këtij viti, kur u bë objekt i një atentati me tritol në qytetin e Shkodrës. Rreth 500 gramë C4 u vendos në një motocikletë të parkuar afër fuoristradës së tij, ndër-sa shpërthimi i shkaktoi dje-



Biznesmeni shkodran, Lulzim Kulla

Kulla u arrestua pasi u kap në pikën kufitare të Kakavijës me një pasaportë të falsifikuar në tentativë për të ikur në Greqi. Kulla rezultoi se në korrik të vitit 2014 është pajisur me një pasaportë me të dhëna të falsifikuara.

HISTORIA

Kulla akuzohet se ka marrë pjesë në torturimin deri në vdekje të një prej tregtarëve, që nuk i është bindur diktatit të tij. Bëhet fjalë për një tregtar që merrej me shitjen e gazit, për vdekjen e të cilit nuk pati asnjë autor. 43-vjeçari është një nga të arrestuarit për kultivim kanabisi në zonën e Dukagjinit. Edhe pse konsiderohej si një prej organizatorëve për kultivimin e një sasive të madhe të bimëve narkotike, ai u la i lirë pas vetëm 6 muajsh.

egje në 25 për qind të trupit. Në atë kohë, Kulla deklaroi për Policinë se "nuk i njihte autorët dhe nuk kishte dyshime se kush mund ta kish të vendosur tritolin". Ai njihet dhe për shkak të së kaluarës së tij, pasi emri i tij lidhet me disa ngjarje krimina-

le, por që në fund nuk është dënuar. **"I FORTI I SHKODRËS"** Kulla konsiderohej si kreu i një grupi kriminal, që prej vitesh nënshtron tregtarët në Shkodër duke u vendosur "tarifë" të për-muajshme për garantimin

e objekteve tregtare. 43-vjeçari njihet si person i dhunshëm dhe se ka detyruar shumë biznesmenë që të mbyllin aktivitetin e tyre, madje shumë të tjerë edhe janë detyruar që të largohen nga qyteti i Shkodrës. Kulla akuzohet



Gjykata e Gjirokastrës



KULLA

Lajmi për lirimin e Kullës e konfirmon avokati i tij Detar Hysi. Sipas avokatit, nuk provohet fajësia ndaj klientit të tij. Kujtojmë se Kulla u arrestua pasi u kap në pikën kufitare të Kakavijës me një pasaportë të falsifikuar në tentativë për të ikur në Greqi

Avokati

se ka marrë pjesë në torturimin deri në vdekje të një prej tregtarëve, që nuk i është bindur diktatit të tij. Bëhet fjalë për një tregtar që merrej me shitjen e gazit, për vdekjen e të cilit nuk pati asnjë autor. 43-vjeçari është një nga të arrestuarit për kultivim kanabisi në zonën e Dukagjinit. Edhe pse konsiderohej si një prej organizatorëve për kultivimin e një

sasie të madhe të bimëve narkotike, ai u la i lirë pas vetëm 6 muajsh. Në operacionin dyditor të gushtit 2016, u zbuluan mbi 40 parcela me kanabis me mbi 10 mijë rrënjë. Ndonëse policia arrestoi shumë persona të akuzuar si organizatorë të kultivimit të bimëve, mes së cilëve ishte dhe Lulzim Kulla, shumë prej tyre u lanë të lirë për mungesë provash.

Banorët: Duhet të ketë përmirësim në orare

Të rinjtë e fshatit Katund i Ri, të 'izoluara' prej transportit

PROJEKTI

Qëllimi i projektit "Lëviz për të votuar" dhe trajnimit është sensibilizimi i votueseve të rinj për votën dhe mbledhja e problematikave të ngritura prej tyre. Në fund të takimit nga të rinjtë u parashtruan një sërë çështjesh dhe problemesh si: Mungesë librash në bibliotekën e shkollës "Isuf Hoti" dhe në shkolla të tjera. Nevoja e një qendre sociale për njerëzit në nevojë. Kërkohen terrene sportive dhe kulturore. Ngritja e një qendre rinore, për aktivizimin e të rinjve.



Në fshatin Katund i Ri në qytetin e Durrësit, të rinjtë përballen me shumë vështirësi. Linja e autobusit ka vetëm një orar dhe nisat menjëherë pas mësimit në shkollën "Isuf Hoti". Kjo i pengon të rinjtë të angazhohen në shumë aktivitete qofshin këto pranë shkollës apo jashtë saj. Maturantët u shprehën se ndihen të 'izoluara' për të marrë pjesë në aktivitete në qytet për shkak se deri në orën 3-4 ka autobusë. Gjatë një forumi të zhvilluar nga "Qendra për Trashëgimi dhe Edukim" në kuadër të projektit "Lëviz për të votuar", të rinjtë shfaqën si problem kryesor transportin. Edhe për banorët e zonës, mjetet e transportit janë problematike dhe ka

nevojë për përmirësim si në orar edhe në shtimin e kapaciteteve. Qëllimi i projektit "Lëviz për të votuar" dhe trajnimit është sensibilizimi i votueseve të rinj për votën dhe mbledhja e prob-

lematikave të ngritura prej tyre. Në fund të takimit nga të rinjtë u parashtruan një sërë çështjesh dhe problemesh si: Mungesë librash në bibliotekën e shkollës "Isuf Hoti" dhe në shkolla të tjera.

Nevoja e një qendre sociale për njerëzit në nevojë. Kërkohen terrene sportive dhe kulturore. Ngritja e një qendre rinore, për aktivizimin e të rinjve. Salla kompjuterësh dhe ngritja e labo-

ratorëve nëpër shkolla. Investime në përmirësimin e kushteve nëpër shkolla, duke filluar që nga uji nëpër tualete që mungon. Mungesë trotuarezesh nëpër lagje. Problematike është dhe lin-

ja e transportit si për nxënësit e shkollave ashtu edhe për banorët. Autobusi që transporton nxënësit ka një orar të kufizuar dhe largohet menjëherë pas mësimit.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



PENSIONET E USHTARAKËVE PROBLEMATIKAT

Flet kreu i shoqatës: Preken mijëra persona, kanë fituar gjyqet për pensionet e parakohshme

Kategoritë e ushtarakëve që duhet të kthejnë pas deri në 37 milionë lekë

Thoma Konduri: Rritja e pensioneve me 2.8%, qesharake

Voltiza Duro

Mbi 1 mijë ushtarakë që kanë fituar gjyqet mbi pensionet e parakohshme ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore duhet të kthejnë mbbrasht paratë që kanë marrë nga vendimet e formës së prerë. Nëpërmjet një vendimi unifikues, Gjykata e Lartë ka rrëzuar vendimet që kanë shpallur fitues të proceseve gjyqësore ushtarakë e si pasojë këta të fundit duhet të dorëzojnë 2-37 milionë lekë të vjetra. Në një intervistë për "Gazetën Shqiptare", Thoma Konduri, president i Shoqatës Kombëtare të Ushtrake në Rezervë të Shqipërisë tregon se me daljen e vendimit të Zaganjorit, të vitit 2016, ushtarakët që i kapi ky vendim janë të detyruar të kthejnë paratë. Sipas tij ISSH bën shkelje pasi nuk zbaton vendimin sipas ligjit (mbahen deri në 20% të pensionit suplementar) por i mbajnë ushtarakut në masën 100% pensionin suplementar. Konduri thekson se ka patur raste ku ushtarakëve iu janë mbajtur para edhe nga pensioni i pleqërisë deri në 50% të tij. Me tej ai shton se rritja e pensioneve me 2.8% për ushtarakët është qesharake e kërkon që të bëhen korrjigjimet pasi ka një diskriminim mes ushtarakëve që kanë dalë në pension para 31 dhjetorit të 2014-ës me ata që kanë dalë në janar në vitin 2015.

A janë të kënaqur ushtarakët nga rritja e pensionit me 2.8%?

Deri më tani nuk kemi ndonjë premtim për shtesë pensioni e këtu bëhet fjalë për mijëra ushtarakë në lirim që kanë shkëputur marrëdhëniet aktive nga ushtria. Vetëm vendimi që është marrë në korrik për indeksimin e pensioneve me 2.8% e kjo shtesë varioonte sipas masës së pensionit, por një rritje e papërfillshme me 7-9 mijë lekë të vjetra. Kjo rritje na duket qesharake në krahasim me atë që ne kemi kërkuar e vazhdojmë të kërkojmë.



President i Shoqatës Kombëtare të Ushtrake në Rezervë të Shqipërisë, Thoma Konduri

KERKESAT

Ne kërkojmë që të bëhen korrjigjimet pasi ka një diskriminim mes ushtarakëve që kanë dalë në pension para 31 dhjetorit të 2014-ës me ata që kanë dalë në janar në vitin 2015. Në të njëjtat kushte, dalja në pension me vetëm një ditë i diferencën ushtarakët me një masë pensioni prej 100 mijë lekësh të vjetra. Ne kërkojmë që të ngushtohet diferenca e pensionit që merr një i liru para 2014-ës me ushtarakët e liruar pas 2015-ës. Gjithashtu, kërkojmë shfuqizimin total të aktit normativ numër 5 që konsiston në uljen e vlerës së pensioneve, nga 1800 lekë në vetëm 12000 lekë të reja.

Cilat janë kërkesat tuaja drejtuar instancave përkatëse?

Ne kërkojmë që të bëhen korrjigjimet pasi ka një diskriminim mes ushtarakëve që kanë dalë në pension para 31 dhjetorit të 2014-ës me ata që kanë dalë në janar në vitin 2015. Në të njëjtat kushte, dalja në pension me vetëm një ditë i diferencën ushtarakët me një masë pensioni prej 100 mijë lekësh të vjetra. Ne kërkojmë që të ngushtohet diferenca e pensionit që merr një i liru para 2014-ës me ushtarakët e liruar pas 2015-ës. Gjithashtu, kërkojmë shfuqizimin total të aktit normativ numër 5 që konsiston në uljen e vlerës së pensioneve, nga 1800 lekë në vetëm 12000 lekë të reja. Deri në dhjetor të 2014-ës ligji ven-

doste një tavan për pensionet, në bazë të së cilit një ushtarak i liru nuk mund të merrte më shumë se dy pensione bazë. Një pension bazë është 12500 lekë të reja; edhe pse pensioni sipas llogaritjeve mund të shkonte më tepër, nuk kishte të drejtë të shpërbleheshe më shumë se 25000 lekë të reja. Ndërkohë, për të gjithë të liruarit pas janarit të vitit 2015-të, ky ligj nuk zbatohet më.

Si mund t'i jepet një zgjidhje situatës dhe a keni bërë ndonjë kërkesë në lidhje me këtë problematikë pranë instancave përkatëse?

Kjo mund të rregullohet vetëm nëpërmjet indeksimit të diferencuar. Bëhet fjalë për diferenca para dhe pas 2015-ës, që variojnë me 60, 70

STATUSI I USHTARAKUT

Statusin e kemi, por nuk po gjen zbatim. Kemi vite që flasim për zbatimin e statusit të ushtarakut, por mesa duket qeveria dhe institucionet përkatëse nuk duan të zbatohet statusi e ne jemi lodhur tashmë. Statusi ka mbi 18 nene që iu japin të drejta apo detyra, ushtarakëve që kanë ndërprerë karrierën, e në këto vite nuk ka asnjë VKM apo udhëzim që të hapi rrugën e zbatimit të neneve përkatëse.

e deri në 150 mijë lekë të vjetra, diferencë mes masave të pensionit. Duhet të indeksohet pensioni me një vlerë më të madhe për ata që kanë dalë në pension para 2014-ës me ata që kanë dalë në 2015-ën. Në këtë mënyrë do të ngushtohet "gërshëra". Kemi bërë një kërkesë për ta zgjidhur këtë problematikë, por strukturat e qeverisë nuk e pranojnë dhe e kanë deklaruar hapur këtë gjë. Kemi biseduar edhe me përfaqësues nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe na kanë thënë që nuk mund të realizohet ky ngushtim diferencimi.

Sa variojnë masat e parave që duhet të rikthejnë ushtarakët dhe sa persona preken nga ky vendim?

Në bazë të vendimit të gjykatave administrative të gjithë ushtarakët që kanë pasur dosjen në Gjykatën e Lartë duhet të kthejnë paratë që kanë fituar me të drejtë. Më specifikisht bëhet fjalë për mbi 1 mijë ushtarakë që kanë fituar gjyqet lidhur me pensionet e parakohshme ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore me vendime të formës së prerë e më tej ISSH ka apeluar në Gjykatën e Lartë. Me daljen e vendimit të Zaganjorit, të vitit 2016, ushtarakët që i kapi ky vendim janë të detyruar të kthejnë paratë. ISSH bën sërish shkelje pasi nuk zbaton vendimin sipas



ligjit (mbahen deri në 20% të pensionit suplementar), por i mbajnë ushtarakut në masën 100% pensionin suplementar, duke shkelur rëndë ligjin. Kemi kërkuar që të verifikohen këto shkelje të ligjit por deri më tani nuk është vënë dorë. Procesi i kthimit të lekëve ka nisur e përveç pensionit suplementar, ka patur raste ku ushtarakëve iu janë mbajtur para edhe nga pensioni i pleqërisë deri në 50% të tij. Pra, mbi 100 mijë lekë të vjetra ushtarakëve iu mbahen nga shteti. Pra, vetë gjykatësit, kanë marrë dy vendime e kanë mbajtur dy qëndrime për të njëjtën çështje e kjo neqet në ndërgjegjeve e tyre. Vlera e parave që duhet të kthejë një person varion nga 2-37 milionë lekë të vjetra.

Sa të kënaqur janë ushtarakët në lirim apo ata që kanë dalë në pension me masën e pensionit?

Ashtu si shpjegova, vetë ligji që ka dalë pas 2015-ës, i diferencën pensionistët dhe krijon pakënaqësi. Kërkojmë indeksim të diferencuar. Kështu që instancat përveçgjëse

Sa zbatohet statusi i ushtarakut në vendin tonë?

Statusin e kemi, por nuk po gjen zbatim. Kemi vite që flasim për zbatimin e statusit të ushtarakut, por mesa duket qeveria dhe institucionet përkatëse nuk duan të zbatohet statusi e ne jemi lodhur tashmë. Statusi ka mbi 18 nene që iu japin të drejta apo detyra, ushtarakëve që kanë ndërprerë karrierën, e në këto vite nuk ka asnjë VKM apo udhëzim që të hapi rrugën e zbatimit të neneve përkatëse. Vetëm për

nenin 35 janë bërë 7 ligje që kanë kundërshtuar njëri-tjetrin dhe 4 vendime të Gjykatës Kushtetuese si dhe një vendim unifikues i Gjykatës së Lartë. Si mund të zbatohen kur qeveria nuk nxjerr vendim për këto nene e kur ministria nuk nxjerr udhëzime, e për këtë nuk po mban asnjë përgjegjësi as administrative, as morale, dhe as ligjore. Nuk zbatohen ligjet, sëmundje që ka filluar që në 1991-in. Qëndrimi ndaj ne që kemi dalë në pension demotivon edhe ushtarakët që janë në detyrë. Shumë nga elementët e Statusit kanë nevojë vetëm për mirënjohje të kontributit të ushtarakëve dhe respekt për ta pas ndërprerjes së karrierës.

Cilat janë kërkesat e ushtarakëve në lirim ndaj shtetit shqiptar?

Ka një sërë kërkesash ndër të cilat mund të përmendim: nxjerrja e VKM për transferimin e shërbimeve të spitalit ushtarak, për ceremonialin mortar të ushtarakëve që ndahen nga jeta; nxjerrja e urdhrat të Ministrisë të Mbrojtjes për t'i dhënë të drejtë të gjithë ushtarakëve të vendit, në rezervë, në lirim a në pension që të frekuentojnë shtëpitë e pushimit të ushtarakëve, pasi në të shumtën e rasteve bllokohen nga civilë që nuk kanë kurrfarë lidhje me ushtrinë. Gjithashtu, bazuar në nenin 42, ushtaraku ka të drejtë të marrë pjesë në të gjitha ceremonitë festive apo përkujtimore, por Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm apo komandat rajonale nuk kanë protokoll për këtë.



Formula e përllogaritjes. Shembujt konkretë, masa që përfiton çdo kategori

Eksperti i pensioneve: Pensionet e ushtarakëve, çështje e ndërlikuar

Kosta Barjaba: U janë drejtuar gjykatave, ka ende punë për të bërë

Voltiza Duro

Edhe ushtarakët kanë përfituar nga rritja e pensionit në masën e indeksuar prej 2.8% që prej muajit korrik. I pyetur nga "Gazeta Shqiptare", eksperti i njohur i pensioneve, prof.dr Kosta Barjaba tregon se pavarësisht punës së bërë deri më tani, ushtarakët janë ende të pakënaqur e madje shumë prej tyre kanë trokitur dyerve të gjykatave për të drejtat e tyre. "Skema e pensioneve të ushtarakëve ka pasur veçoritë e saj, si dhe ushtarakët kanë pasur probleme të ndryshme me qeveritë, sepse një qeveri ia ka njohur, një tjetër nuk ia u ka njohur. Madje një pjesë e tyre janë detyruar të shkojnë dyerve të gjykatave për të kërkuar të drejtat e tyre. Është një çështje e ndërlikuar por unë di që vitet e fundit ka patur një predispozitë më të madhe për të gjetur një zgjidhje më me themel për çështjen e pensioneve të ushtarakëve. Gjithsesi është një çështje që ende do punë pasi shkalla e kënaqësisë së kësaj kategorie nuk është maksimale. Akoma duhet të bëhet më shumë, sepse duhet marrë parasysh edhe lloji i punës dhe vështirësia që ka pasur kjo punë", thekson Barjaba për "GSH".

PËRFITUESIT

"Këshilli i Ministrave vendosi indeksimin, në masën 2.8 për qind, të pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut"; trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektive, oficerë dhe nënofficerë, lundruer të nëndetëseve dhe palombarëve të forcave detare në pension", thuhet në vendim. Më tej në këtë të fundit bëhet me dije se nga kjo rritje do të preken edhe trajtimet e veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të indus-



Prof.dr Kosta Barjaba

trisë ushtarake". Ky indeksim do të bëhet në bazë të rishikimit të ligjit "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji. Ndërkohë indeksimin, e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.7.2018 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 30.6.2018, përfshirë edhe këtë datë. "Shuma bazë e pensionit, e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duke filluar nga data 1.7.2018 e në vazhdim të jetë 7 262 lekë. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përllogariten në shumën 1 545 000 000 lekë dhe përballohen nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e ISSH-së të vitit 2018", nënvizohet më tej në vendim. Edhe ushtarakët që kanë punuar në një prej institucioneve të për-

caktuara me ligj kanë të drejtën e përfitimit të pensionit suplementar. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përfitim suplementar kanë të drejtë të marrin të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë; punonjësit e Policisë së Shtetit; ata të Gardës së Republikës, punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit si dhe ata të Policisë së Burgjeve. Gjithashtu, nga pensioni suplementar mund të përfitojnë edhe punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, ata të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm si dhe punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes. Sipas ligjit, ka disa lloj përfitimesh që administrohen nga ISSH-ja, e respektivisht bëhet fjalë për: pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi; pensionin suplementar të pleqërisë; pensionin suplementar të invaliditetit; si dhe për atë familjar. Kështu për të përfituar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, burrat duhet të kenë mbushur moshën 47 vjeç e të kenë jo më pak se 15 vite pune, ndërsa gratë duhet të jenë mbi 42 vjeç e të kenë jo më pak se 12 vite shërbimi. Ndërkohë mund të përfitojnë pensioni suplementar pleqërie të gjitha

kategoritë e sipërpërmendura, dhe pensioni suplementar invaliditeti po këto kategori që janë deklaruar invalidë dhe përfitojnë pension invaliditeti të plotë apo të pjesshëm, sipas Ligjit nr. 4171, "Për sigurimet shoqërore të RPSH" dhe Ligjit nr. 7703, "Për sigurimet shoqërore në RSH". Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se kur personat e familjes në ngarkim të personave të sipërpërmendur dhe familjet e ushtarakëve që humbasin jetën në krye të detyrës e përfitojnë pension familjar, sipas ligjit kanë, gjithashtu, të drejtën e marrjes së pensionit suplementar familjar.

FORMULA E LLOGARITJES

Llogaritja e një pensioni suplementar të pleqërisë bëhet sipas formulës: PSP = PMRMN x VSH x 1% ku PSP nënkupton pensionin Suplementar të Pleqërisë; PMRMN është Paga Mesatare Referuese Mujore Neto; ndërsa VSH janë vitet e Shërbimit. Por masa që rezulton nga kjo formulë nuk duhet të jetë më shumë se 50 për qind e pensionit të pleqërisë.

SHEMBUJ KONKRETË

Nëse një ushtarak përfiton pension pleqërie sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, dhe masën 26,000 lekë në muaj; ai ka 28 vite shërbimi si ushtarak dhe pagë mesatare referuese mujore neto 53,700 lekë në muaj. Llogaritja e pensionit suplementar të pleqërisë bëhet në këtë mënyrë: PSP = 53,700 lekë x 28 vite x 1% = 15,036 lekë / muaj. Por, pensioni suplementar i pleqërisë nuk duhet të jetë më i lartë se 50% e pensionit të pleqërisë që ushtaraku gëzon, në rastin e lindjes së të drejtës së pensionit suplementar. Kështu ushtaraku përfiton pension pleqërie në masën 26,000 lekë/muaj. Në këtë rast, pensioni suplementar i pleqërisë është sa 50% e pensionit të pleqërisë, pra 13,000 lekë / muaj. Pra, ish ushtaraku do të përfitojë pensioni suplementar pleqërie në masën 13,000 lekë/muaj.



Shembull

LLOGARITJA E PENSIONIT

Llogaritja e pensionit suplementar të pleqërisë bëhet në këtë mënyrë: PSP = 53,700 lekë x 28 vite x 1% = 15,036 lekë / muaj. Por, pensioni suplementar i pleqërisë nuk duhet të jetë më i lartë se 50% e pensionit të pleqërisë që ushtaraku gëzon, në çastin e lindjes së të drejtës së pensionit suplementar.

KATEGORITË PËRFITUESE:

- Ushtarakët e Forcave të Armatosura në RSH;
- Punonjësit e Policisë së Shtetit;
- Punonjësit e Gardës së RSH;
- Punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit;
- Punonjësit e Policisë së Burgjeve;
- Punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit;
- Punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm;
- Punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Rrëfihet psikologjia: Zgjidhjet që jap për rastet e vështira, ja sa na besojnë njerëzit

Anxhela Peza:

Nuk ka formula të gatshme për ata që i kanë dhënë fund një raporti

"Lumturi për gjithë jetën nuk ka për askënd"

Egla Xhemali

Të jesh psikologe do të thotë të luftosh çdo ditë për problematikat sociale të njerëzve, si dhe të gesh mënyrën më të shpejtë që t'i qetësosh ata. Herë-herë psikologu arrin të gjejë çelësin magjik për të dekodifikuar gjendje emocionale të ndryshme dhe për të risjellë paqen e çdokujt që i drejtohet. Për "Gazeta Shqiptare", Anxhela Peza rrëfeu problematikat e të rinjve, zgjidhjet e shpeshta që ajo ofron, rastet më të vështira që ka ndjekur, si dhe këshillat që jep për një raport që sapo ka përfunduar. Psikologjia punon dhe e do fort atë që bën. Çdokush që tenton të ndihmojë sadopak të tjerët e ka shpirtin plot nga falënderimet për veprën e jashtëzakonshme. Anxhela ka vite që u ka dhënë zgjidhje shumë problemeve të atyre që i janë drejtuar. Peza hedh dritë mbi disa aspekte të jetëve njerëzore, që ndonjëherë vetëm këshillimi me specialistët i jep rrugëzgjidhje.


Problematikat që përballen të rinjtë sot?

Të rinjtë në vendin tonë përballen shumë me një problem madhor, i cili është papunësia. Të mos punësuarit një profesion është faktori i dytë fill pas të parës. Më pas do të rreshtojnë problemet sociale në familje dhe shoqëri, përdorimi i lëndëve narkotike, varësia me bixhozin etj. Ndërsa në problemet e natyrës psiko-emocionale janë depresioni, çrregullimet me ankthin, problemet e personalitetit.

Çfarë roli luani ju në zgjidhjen e tyre?

Në profesionin tim jemi të përgatitur dhe të prirur për të lehtësuar gjendjen aktuale, reduktimin e problemit apo simptomave drejt një zgjidhjeje të duhur për të riun. Edhe zgjidhja kërkon kohën e saj, se nuk mund të vijë në një hark kohor të shkurtër.

Rasti që do të cilësonit më të vështirin?



Kam disa të cilat nuk mund t'i ndaj, përdhunimi i një vajze nga babai për 14 vite me radhë, dy vajza të vogla 8 dhe 9 vjeçe, që kërkonin ndihmë në mënyrë të dëshpëruar se i ati i gjëmonte për t'i vrarë. Përdhunimi i një 9-vjeçare nga mësuesi brenda ambienteve të shkollës. Raste të cilave është vështirë t'u ndryshosh realitetin kur drejtësia nuk vihet në vend për to. Sepse nëse shumë çështje nuk zgjidhen nga ana ligjore, kurrësi nuk mund të

ndihmohet në paqen shpirtërore të njeriut. **Sa besim krijojnë njerëzit për t'i ndarë përjetimet me një psikolog?** Është e ditur që vendi ynë e ka pak vështirë për t'i ndarë ndjesitë dhe shqetësimet e brendshme me një psikolog. Psikologjia ka hyrë në studim tek ne përpara 20 vitesh dhe vitet e fundit po llobohet për këtë lloj ndihme, që individit mund t'i drejtohet. Unë mendoj se besimi po rritet

dita-ditës, përdërisa njerëzit drejtohen tek psikologu dhe punë ka.

Cila është terapia më e mirë për një jetë të lumtur?

Jam angazhuar në profesion duke qenë vullnetare që në moshën 19-vjeçare dhe deri tanimë shikoj përditë se dashuria mund të shërojë gjithçka dhe të sjellë gëzim lumturi te njerëzit. Duke vënë në dukje edhe rastet e vështira.

Çfarë do të thotë ta marrësh jetën si të vjen?

Më pëlqen shumë një shprehje e popullit tek thotë "Çfarë i ra njeriut dhe nuk e hoqi". Sa më shumë të pranosh atë që të ndodh, aq më shpejt reagon për të bërë përpara e për të gjetur zgjidhje. Natyrisht që trauma dhe problemet e mëdha mbeten të qepura në lëkurën e njeriut ndoshta edhe për gjithë jetën, por ajo që është e vlefshme të jetosh jetën me të gjitha ngjyrat e saj. Të thuash që "po, jetova në furtuna dhe ditët me diell". Lumturi pafund për gjithë

jetën nuk ka për askënd. **Kur përfundon një raport? Këshilla më e mirë për ta kaluar dhimbjen?**

Çdo rast është specifik, ka veçantinë e tij në mënyrën e përshkrimit, trajtimit dhe llojit të terapiisë që ndjek më të. Nuk ka formula të gatshme.

Cila është mënyra përmes së cilës një maskull mund të lexojë drejt një femër?

Të mos lodhet shumë për ta lexuar e as kuptuar, por të lodhet për ta dashuruar. Të shikojë bukur mënyrën e saj.



I thonë po vdes për vëmendje, shihni reagimin epik të Oriola Marashit

Modelja Oriola Marashi këto ditë është me pushime në Dubai, prej nga iku ka publikuar shumë foto e video seksi. E sigurisht që nuk mund të mungonte një postim i saj lidhur me festën e 28 Nëntorit ditën e djeshme, ku uroi festën, por ishte paksa ironike, teksa postoi një foto seksi dhe një shprehje të bukur që nënkupton se Shqipërinë duhet ta duam çdo ditë. "Meqenëse jeta dhe siguria e secilit është e lidhur me fatin e të gjithë atyre që, së bashku, formojnë kombin, do të na donte shpirti që çdokush të sakrifikojë pesë minuta në njëzet e katër orë dhe të hetoje nga thellësia e vetes së tij se ç'shërbim ka bërë për shoqërinë dhe ç'të mirë mund t'i bëjë kësaj shoqërie që quajmë komb. Me duaj çdo ditë, jo vetëm sot - tha Shqipëria! Gëzuar datëlindjen!" Mirëpo komentet e fansave ishin të shumtë dhe një prej tyre i tha se po vdes për vëmendje dhe nxjerr by**ën për Festën e Flamurit. Por Oriola nuk mund t'i kthente një përgjigje më ironike se kjo pasi e etiketoi dhe i tha: "Më fal, por a e din të shpisë".



Motrat Istrefi bëjnë shqiponjën në mes të Athinës, acarohen grekët

Sot Shqipëria dhe shqiptarët festojnë anembanë botës dhe motrat Istrefi kanë zgjedhur të festojnë për Ditën e Flamurit në Greqi. Ato kanë publikuar vazhdimisht foto gjatë ditës së sotme dhe në shumë prej tyre kanë treguar se po festojnë. Madje, në një fotografi të postuar nga Era, të dyja shihen me plis në kokë, duke bashkuar duart për të bërë shqiponjën, Era ka shkruar: "Krenarë kudo që jemi", por fansat e saj grekë nuk e kanë pëlqyer aspak dhe e kanë cilësuar si provokim këtë dhe mungesë respekti.



"E urrej punën time", deklarata e Adrolës që i habiti të gjithë

Modelja e njohur Adrola Dushi mund të konsiderohet si një ndër femrat më të bukura shqiptare dhe jo pa të drejtë. Ajo në 2012-tën fitoi kurorën e "Miss Universe" dhe prej atij viti ka qenë në qendër të mediave shqiptare. E ftuar së fundmi në emisionin "Pasditja ime" Adrola rrëfeu për karrierën e saj në Amerikë dhe për herë të parë bëri deklaratën befasuese, duke treguar se e urren punën e saj. Duke u bazuar tek rrjetet sociale, ku sipas saj çdo vajzë hiqet si modele, ajo tashmë e ka për ofendim të quhet një e tillë. "E urrej punën time. Nuk do të doja këtë moment të quhesha modele ose miss, në periudhën që po jetojmë. Ndiheh disi e ofenduar, ngaqë po shoh rreth e rrotull dhe ka humbur sensi i gjësë. Nuk po e shijoj fare", - është shprehur ajo.



Janë ndarë prej vitesh, por Noizy ka ca fjalë për ish-të dashurën

Reperi Noizy dhe këngëtari Altin Sulku kanë qenë bashkë mbrëmë për të festuar ditëlindjen e një miku të afërt. Noizy ka mbajtur të informuar ndjekësit e tij në "Instagram" me video nga momentet e argëtimit me kushëririn e tij. Por ajo që na tërhoqi vëmendjen ishte fakti që këngëtarja Sheila Haxhiraj ishte gjithashtu pjesë e videove të tij.

Bukuroshja brune është përfolur për lidhjen e saj me reperin vite më parë. Mediat shkruanin në vitin 2012 se Sheila dhe Noizy kanë pasur lidhje përpara se ajo të fitonte "X-Factor". Shfaqja e tyre e parë në publik ishte në "Kënga Magjike 2011", ku Sheila ishte ulur në tavolinën e miqve më të afërt që mbështesnin Noizy-n në konkurrim. Fakti që Noizy publikoi një video të Sheilës duke kënduar, tregon se ata vijojnë të ruajnë miqësinë, pavarësisht gjithçkaje.



Parlamenti maqedonas i heq imunitetin Gruevskit

Azilant në Hungari, ish-kryeministri humbet mbrojtjen e postit me 62 vota pro pa praninë e VMRO-DPNE

Parlamenti i Republikës së Maqedonisë me 62 vota pro e pa debat, të martën në mbrëmje, në seancë plenare pranoi rekomandimin e Komisionit për Çështjet e Rregullores, Imunitetit dhe Mandatit për heqjen e imunitetit të ish-kryeministrit dhe deputetit, Nikolla Gruevski, edhe me kërkesën e gjykatës për shkak të caktimit të masës së paraburgimit.

EKSTRADIMI

Dje pritej që të bëhej ekstradimi i ish-kryeministrit të Maqedonisë, Nikolla Gruevski nga Hungaria, të mbështetet edhe nga shumica e deputetëve të Parlamentit Europian. Tashmë ish-kryeministri është azilant në Hungari me miratim të kryeministrit të vendit si dhe mikut të tij, Viktor Orban.

Në seancë nuk morën pjesë deputetët e opozitës nga VMRO-DPMNE-ja, ku Gruevski është kryetar

nderi. Ndërkohë pritej që dje të bëhej ekstradimi i ish-kryeministrit të Maqedonisë Nikolla Gruevski

nga Hungaria, të mbështetet edhe nga shumica e deputetëve të Parlamentit Europian. Tashmë ish-kryeministri është azilant në Hungari me miratim të kryeministrit të vendit si dhe mikut të tij, Viktor Orban. Azili i marrë nga ish-kryeministri Nikolla Gruevski i jep atij të drejtën për të lëvizur lirshëm vetëm në territorin hungarez, por jo më tej, shpjegon profesorja e të



Ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski

drejtave të njeriut Mirjana Najçevska. Nëse ai largohet nga Hungaria, një urdhër arresti ndërkombëtar do të aktivizohet dhe ai do të arrestohet, siç u arrestua kryeministri kroat Sanader, kur ai shkoi në Austri.

Fleckenstein: Kosova të heqë taksën, Serbia të mos pengojë përparimin

Dialogu Kosovë-Serbi mbetet një nga temat më të rxehta të Ballkanit dhe më gjerë duke bërë kështu që ndërkombëtarët të reagojnë për zgjidhjen e këtij ngërçi. Së fundmi ka qenë këshilltari i presidentit Trump për Sigurinë Kombëtare John Bolton, i cili tha se momenti është tani për Kosovën dhe Serbinë të arrijnë një marrëveshje. Zyratari i lartë i Shtëpisë së Bardhë i bëri këto komente të martën përmes një postimi në Twitter pas takimit me presidentin e Kosovës Hashim Thaçi. Zoti Bolton tha se Shtetet e Bashkuara janë të gatshme të ndihmojnë të dyja palët drejt arritjes së këtij synimi historik. Nga ana tjetër presidenti i Kosovës ndodhet në Washington në një vizitë zyrtare. Të hënën Thaçi u takua me Sekretarin e Shtetit Michael Pompeo. Sipas zëdhënësës së Departamentit të Shtetit, zoti Pompeo përcolli të njëjtin mesazh, duke u bërë thirrje të dyja palëve të shfrytëzojnë mundësinë që është krijuar për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve.

Dialogu Kosovë-Serbi, SHBA: Është koha për marrëveshje

Thaçi në Amerikë, Pompeo kërkon normalizim të gjendjes



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

jëherë saktë se çfarë nënkupton me të. Nuk dihet nëse ekziston ndonjë projekt-dokument për këtë ide, që sipas zotit Thaçi është mënyra më e mirë për të kapërcyer përpjekjet disavjeçare për normalizimin e marrëdhënieve që nuk kanë sjellë ndonjë rezultat. Në Kosovë kjo ide është pritur me kritika të ashpër nga shumica e forcave politike. Përplasjet mes presidentit dhe kryeministrit janë bërë tashmë publike. Gjatë vizitës në Washington, në komentet pas takimeve me sekretarin Pompeo dhe zotin Bolton, presidenti Thaçi nuk e ka përmendur idenë e "korrigjimit" të kufirit, por ka falënderuar palën amerikane për gatishmërinë për të ndihmuar Kosovën në përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Një krizë e re ka lindur ditët e fundit në marrëdhëniet mes dy vendeve, pas tarifave prej 100% që qeveria e Kosovës ka vendosur ndaj importeve serbe, në shenjë hakmarrje ndaj politikës së vazhdueshme të Beogradit për të bllokuar anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Sekretari i Shtetit Pompeo i bëri thirrje presidentit Thaçi që Kosova t'i heqë tarifat tregtare ndaj Serbisë. Kosova duhet të heqë doganat, por edhe Serbia duhet të mos e pengojë Kosovën në përpjekjet e saj, edhe pse nuk e mbështet si shtet, thekson eurodeputeti gjerman, Knut Fleckenstein për "Deutsche Welle"-n. Lidhur me këtë vendim të

Kosovës Fleckenstein ka thënë: "Bashkëpunimi rajonal në ekonomi është vendimtar. Dogana të reja do të thotë të ecësh gjithmonë një hap mbrrapa, në vend që të ecet drejt njëri-tjetrit. Ne i trembemi një ashpërsimi të mëtejshëm të fronteve me doganat e reja, prandaj bëj thirrje, ashtu si e ngarkuara e lartë e BE-së për Politikën e Jashtme, Federica Mogherini për vetëpërmbytje dhe heqjen e doganave nga ana e Kosovës, të cilat shkelin edhe thelbin e marrëveshjes ekonomike, CEFTA. Palët duhet që në dialog të dërgojnë sinjale të paqes dhe bashkëpunimit". Ndërkaq lidhur me këtë vendim eurodeputeti ka thënë se është si pasojë mospranimi në

Interpol të Kosovës si dhe procesit të zvarritur të liberalizimit të vizave. "Bashkësia ndërkombëtare kërkon një Kosovë të stabilizuar, me aftësi duaruese, kjo do të kishte efekt pozitiv edhe në procesin e njohjeve të Kosovës si shtet. Por ne presim edhe nga Serbia, që të mos i pengojë përpjekjet e Kosovës drejt një shteti të njohur plotësisht, edhe nëse nuk i mbështet ato. Një fqinjësi e mirë mes të dy vendeve, Kosovës dhe Serbisë është qendrore për paqen në Ballkan. Fillimi i bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë është një sukses historik që i dedikohet Federica Mogherinit. Ne kemi besim në rolin e saj si ndërmjetësuese", ka thënë Fleckestein.

KNUT FLECKESTEIN
"Një fqinjësi e mirë mes të dy vendeve, Kosovës dhe Serbisë është parësore për paqen në Ballkan. Fillimi i bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë është një sukses historik që i dedikohet Federica Mogherinit. Ne kemi besim në rolin e saj si ndërmjetësuese", - ka thënë Fleckestein.



Taksa për Serbinë, Admirali i NATO-s: Kosova rrezikon izolimin

Një tjetër reagim ka nardhur pas vendosjes së taksës 100% të Kosovës ndaj Serbisë. Admirali James Foggo, komandant i Forcave të Përbashkëta Aleate në Napoli shprehet kundër vendosjes së taksës nga Kosova prej 100% për mallrat serbe. Ai deklaroi se ky vendim do të sillte izolimin e Kosovës. "Tarifa e vendosur 100% nga Kosova për mallrat e Serbisë rrezikon që ta izolojë Kosovën", -tha Admirali Foggo. Më 21 nëntor qeveria e Kosovës rriti taksën nga 10 në 100 për qind për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, si shenjë ndëshkimi për fushatat dëmtuese të Serbisë në arenën ndërkombëtare dhe barrierat për prodhimet "Made in Kosova".

Presidenti Poroshenko firmos dekretin luftarak: S'është shaka

Arrestimi i 24 marinarëve, Ukraina në luftë me Rusinë

Kapja e pengjeve, Trump mund të anulojë takimin me Putin

Një kirurg në shtetin indian të Gujarat-it është arrestuar për një operacion cesarian në gjendje të dehur ndaj një gruaje shtatzënë. "BBC" raporton se foshnja u deklarua i vdekur pas operacionit, ndërsa pak më vonë vdiq edhe gruaja. Mjeku u konfirmua i dehur pas një testi alkooli, ndërsa autoritet po hetojnë nëse vdekjet e nënës dhe fëmijës u shkaktuan nga neglizhenca apo si pasojë e arsyeve të tjera mjekësore. Dr. P.J. Lakhani është një mjek me eksperiencë dhe ka punuar në Spitalin Shtetëror Sonavala përgjatë 15 viteve të shkuara. Pacientja Kamini Chachi u soll në spital të hënën me dhimbje lindjeje. Media lokale tha se familjarëve u tha se fëmija kishte vdekur, teksa nëna kishte gjakderdhje të madhe. Familja vendosi ta dërgojë në një spital privat, por gruaja ndërroi jetë rrugës.

Prej ditës së djeshme Ukraina është zyrtarisht në gjendje lufte me Rusinë. Presidenti ukrainas Petro Poroshenko nënshkroi dekretin e luftës të miratuar në orët e para të së martës nga parlamenti. Reagimi vjen pas arrestimit të 24 marinarëve ukrainas të dëlnën nga Rusia në ujërat detare përreth Krimesë. Në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombeve, Poroshenko paralajmëroi rrezikun e shpërthimit të një lufte të madhe me Rusinë.

Petro Poroshenko, President i Ukrainës: Numri i tankeve ruse në bazat përgjatë kufirit tonë është trefishuar. Kjo nuk është shaka. Kërkojmë nga Rusia lirinë e menjëhershëm të marinarëve. Në të parin reagim për situatën, presidenti rus drejtoi gishtin nga Perëndimi.

Vladimir Putin, President i Rusisë: Përplasia mes anijeve ushtarake ruse dhe ukrainase është pasojë e dështimit të vendeve të huaja për ta bërë Kievin të japë llogari për sjelljet e këqija kundrejt Rusisë. Një gjykatë ruse në Krime la në arrest me burg 60-ditor 12 nga marinarët e arrestuar. Televizioni shtetëror transmetoi dëshmitë e tre prej marinarëve që pranorin se



Pamje nga arrestimi i marinarëve ukrainas në Rusi

VLADIMIR PUTIN

Përplasia mes anijeve ushtarake ruse dhe ukrainase është pasojë e dështimit të vendeve të huaja për ta bërë Kievin të japë llogari për sjelljet e këqija kundrejt Rusisë. Një gjykatë ruse në Krime la në arrest me burg 60-ditor 12 nga marinarët e arrestuar. Televizioni shtetëror transmetoi dëshmitë e tre prej marinarëve që pranorin se

incidenti ishte provokuar nga ata. **Marinari:** Rrugës për në Mariupol përmes ngushticës së Kerçit, ne hymë në ujërat ruse. Forcat ruse na paralajmëruan se po dhunonin hapësirën e tyre detare. Na paralaj-

jmëruan disa herë. Drejt Krimesë, rusët kanë dërguar përforcime të sistemit raketor s-400 për t'u mbrojtur ndaj çdo kërcënimi. Lidhur me këtë situatë reagoi edhe Presidenti amerikan, Doland Trump, i cili tha se mund do të anulojë takimin me Putinin, ne samitin e G20-ës që do të mbahet këtë javë në Argentinë. Tensionet mes Ukrainës dhe Rusisë që kanë vënë në gjendje lufte vdiq venet mund t'i kushtojnë Rusisë edhe më shtrenjtë. Liderët perëndimorë kanë reaguar ashpër ndaj Moskës, duke i bërë thirrje të tërhiqet. Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës

PETRO POROSHENKO

Numri i tankeve ruse në bazat përgjatë kufirit tonë është trefishuar. Kjo nuk është shaka. Kërkojmë nga Rusia lirinë e menjëhershëm të marinarëve. Në të parin reagim për situatën, presidenti rus drejtoi gishtin nga Perëndimi.

ushtarake, Jens Stoltenberg tha se përdorimi i forcës ushtarake nga Rusia nuk ka justifikim. "Rusia të lirojë menjëherë marinarët ukrainas dhe anijet e sekuestruara dhe. Bëjmë thirrje për qetësi dhe vetëpërmbytje". Edhe BE pritet të reagojë. Sipas një zëdhënësi në Bruksel, Rusia rrezikon sanksione të tjera nga europianët nëse nuk liron pengjet. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjithashtu, kritikuan Moskën për sulmin ndaj anijeve ukrainase. Por presidenti rus Vladimir Putin, në një komunikim telefonik me kancelaren gjermane Angela Merkel tha se anijet ukrainase kishin hyrë në ujërat territoriale ruse duke shkelur marrëveshjen për kalimin e lirë në ngushticën e Kerçit. Sakaq, një gjykatë në Krime vendosi masën e arrestit me 60 ditë për 2 nga 24 marinarët e arrestuar. Ndërsa Rusia publikoi një video të tyre, ku pranorin se kishin vepruar në mënyrë provokative. Por për Kievin, marinarët janë detyruar me forcë të bëjnë ato deklaratat. Situata mbetet delikate, pas vendimit të parlamentit ukrainas për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme për 30 ditë. Ky vendim i kërkuar nga presidenti Petro Poroshenko i jep fuqinë ushtërisë të marrë kontrollin e vendit. Presidenti ukrainas tha se rreziku i një pushtimi terriori, është tejet i lartë.

SHKURT

Horror në Greqi, gjenden trupa emigrantësh në hekurudhë

Skena horrori janë parë nga udhëtarët e trenit në linjën hekurudhore në Komotini, ku disa trupa janë gjetur të prerë dhe copëtuar. Mendohet se ata janë vrarë gjatë së hënës dhe sipas informacioneve paraprake dyshohet të jenë emigrantë, shkruan gazeta "Patratora". Sipas policisë, personat janë shtypur nga treni i linjës Selanikut-Aleksandropolis. Deri më tani, ende nuk dihet numri i viktimave. Trupat u zbuluan nga udhëtarët e trenit mëngjesin e djeshëm në zonën e Filaka Rodopi. Hetimi paraprak po bëhet nga Departamenti i Trafikut të Komotinit.

Britani, ndërron jetë 17 ditë pasi bëri gjoksin

Një nënë e tre fëmijëve në Britani, 17 ditë pasi bëri gjoksin me dëshirën për të përmirësuar pamjen e saj. Louise Harvey, 36 vjeçe, vdiq pasi pësoi një mpiksje të gjakut në gjoks. Harvey filloi të kishte komplikime të frymëmarrjes dhe u dërgua menjëherë në spitalin e Norwich, por ndërroi jetë disa orë më vonë. Lidhur me ngjarjen ka nisur një hetim i detajuar për të kuptuar se çfarë nuk ka shkuar mirë gjatë operacionit. Miqtë e saj kanë hapur një faqe për të mbledhur para për fëmijët e saj - Kayleigh-Anne, 18 vjeç, Owen, 11 dhe Jaxon, 6 vjeç. "Ka qenë një tronditje për të gjithë ne, një nënë e bukur dhe e devotshme për tre fëmijët e saj është larguar prej nesh kaq herët, ajo kishte aq shumë për të jetuar", janë shprehur miqtë e saj.

Emtërrshme! Kirurgu futet i dehur në operacionin e lindjes

Një kirurg në shtetin indian të Gujarat-it është arrestuar për një operacion cesarian në gjendje të dehur ndaj një gruaje shtatzënë. "BBC" raporton se foshnja u deklarua i vdekur pas operacionit, ndërsa pak më vonë vdiq edhe gruaja. Mjeku u konfirmua i dehur pas një testi alkooli, ndërsa autoritet po hetojnë nëse vdekjet e nënës dhe fëmijës u shkaktuan nga neglizhenca apo si pasojë e arsyeve të tjera mjekësore. Dr. P.J. Lakhani është një mjek me eksperiencë dhe ka punuar në Spitalin Shtetëror Sonavala përgjatë 15 viteve të shkuara. Pacientja Kamini Chachi u soll në spital të hënën me dhimbje lindjeje. Media lokale tha se familjarëve u tha se fëmija kishte vdekur, teksa nëna kishte gjakderdhje të madhe. Familja vendosi ta dërgojë në një spital privat, por gruaja ndërroi jetë rrugës.

Pas Hungarisë, Soros mbyll fondacionet në Turqi

"Shoqëri e Hapur" e miliardarit amerikan sulmohej Erdogan: Ka mbështetur terroristët



Miliarderit amerikan, Xhorxh Soros

e Hapur" ka mohuar që të kishte rol në këto protesta. Një nga anëtarët e bordit të

kësaj organizate ishte arrestuar dhe mbajtur në burg për më shumë se 1 vit pa

REXHEP TAIPI ERDOGAN

"Soros ka ofruar mbështetje gjatë protestave të Gezi. Ky është një njeri që ndan popujt dhe i shkatërron. Ai ka kaq shumë para dhe i shpenzon në këtë mënyrë", tha presidenti turk për miliarderin amerikan me origjinë hungareze.

qenë i akuzuar zyrtarisht, tha organizata e George Soros. Para dy ditësh Presidenti turk Erdogan përmendi George Soros në një fjalim. Ai akuzoi biznesmenin Kavala se ka financuar "terroristët gjatë protestave të Gezi", ndërsa për miliarderin Soros tha se ka ofruar mbështetje ndaj tyre. "Ky është një njeri që ndan popujt dhe i shkatërron. Ai ka kaq shumë para dhe i shpenzon në këtë mënyrë", tha presidenti turk për miliarderin amerikan me origjinë hungareze.

Fondacioni "Shoqëri e Hapur" e miliardarit amerikan George Soros, do të ndalojë aktivitetet e saj në Turqi. Njoftimi është bërë nga vet ky fondacion, që argumenton se mbyllja vjen për shkak se janë sulmuar "nga një qeveri gjithnjë e më shumë autoritare". "Shoqëri e Hapur" tha se do të mbyllë zyrën e saj në Stamboll me pretendimin se është bërë objekt i akuzave të pabaza. Qeveria turke ka akuzuar këtë fondacion me protestat e Parkut Gezi në vitin 2013. Ndërsa "Shoqëri

RILINDJA KOMBETARE FRASHERI DHE BIJTE E TIJ

Prof. Dr. Albert Frashëri

Një zjarr mëkatar dhe drita e Frashërit

*Rilindja Kombëtare në sagën e
Frashërit dhe bijve të tij*


Në prag të majit 2014, 100-vjetori i dëgjies së Frashërit, disa miq më patën këshilluar të shkruaja mendimet e mija mbi ato ngjarje, dëgjie e shkatërrime, vrasje e përdhunime nga andartat grekë, që një shekull më parë u krijuan shqiptarëve vuajtje dhe mjerim. Ato ngjarje tragjike e famëkeqe tronditën thellë opinionin shqiptar e atë evropian, duke gjakosur historinë moderne të popujve mesdhetarë. Historia e mesdheut në lashtësinë e vet ka njohur edhe lufta, por edhe mirëkuptim e përpjekje për të kuptuar arsyen e mosmarrëveshjeve.

Jam përpjekur të interpretoj ato ngjarje tragjike të vitit 1914 duke parë në sy vlerat universale të qytetërimit, në mënyrë që të kuptojmë arsyen pse forca e ideve të Rilindjes sonë ndriri natyrshëm mbi errësirën që ato ngjarje donin të sillnin.

Për mua ishte e vështirë t'u jepja një strukturë logjike mendimeve rreth ngjarjeve, për të cilat historia ka shkruar shumë. Nga ana tjetër, ndjej që nuk mund të pranojmë heshtjen e pafalshme rreth ngjarjeve që arsyen njerëzore dënon pa mëdyshje. Italia, fjala vjen, edhe pse kanë kaluar 70 vjet, ka një ditë të Kujtesës historike që i kushton viktimitave të krimeve ndaj italianëve të Istrias, plaçkitjet, shkatërrimet, përdhunimet nga bandat nacionalsheviniste kroate menjëherë pas përfundimit të luftës, më 1945. Italianët e Istrias u përzunë me dhunë nga trojet e tyre, sikundër u vepra me çamët dhe jugun e Shqipërisë gjatë shekullit të fundit.

HIJA E SHOVINIZMAVE NË BALLKAN

Shovinizmi shfaqet si nacionalizëm i sëmurë, që mohon apriori vlerat dhe të drejtat e kombeve të tjera. Konflikti ndërmjet popujve fqinjë ka shoqëruar historinë njerëzore në të gjitha kohërat. Ndryshimi mes konflikteve ndërballkanike dhe atyre të popujve të tjerë evropianë, qëndron në faktin që Shqipëria ka heshtur pa e ngritur problemin botërisht. Europa ka jetuar ngjarje të tilla, por i ka dënuar hapur ato. Studiuesi Simon James të Muzeut Britanik analizon politikën shoviniste të anglezëve ndaj galezëve të Wellsit dhe irlandezëve. Është interesante të kujtojmë qëndrimet shoviniste angleze nga mesi i shek. XIX kundër kulturës dhe gjuhës së galezëve (banorët e Wellsit) që e fyen rëndë krenarinë kombëtare gjeleze. Kjo krijoi një kundërveprim që



sollti rizgimin kulturor të këtij kombi. Në mënyrë të ngjashme, Lidhja e njerëzve të kulturës irlandeze krijuar në vitin 1893, synoi me qartësi dhe fare hapur në çanglizmin e Irlandës duke afirmuar pastërtinë e gjuhës irlandeze dhe vlerën

e folklorit kombëtar të Irlandës.

Le të sjellim ndërmend që 4 shekuj më parë, rreth vitit 1620, Pjetër Budi u bëri thirrje klerikëve të mos pranonin klerikë të huaj në famullitë e tyre e ta bënin liturgjinë në gjuhën amtare,

sepse Perëndia, thoshte ai, na kërkon të flasim gjuhën tonë me besimtarët.

Edhe Skocia ka patur probleme të tilla si Wellsi. Në të gjitha rastet ndryshimet në kohë kanë regjistruar kronika dhune me derdhje gjaku e shpesh edhe me akte terroriste. Këto kombe, për shumë shekuj nën tryshinë e shovinizmit anglez, nuk e kanë fshehur asnjëherë problemin e të kenë rënkuar në heshtje. Përkundrazi, këto dukuri në Ballkan janë shoqëruar të shumtën e herëve nga një heshtje e pafalshme. Dhe kjo është bërë kundrejt zhurmave dhe falseteve të qarqeve nacionalsheviniste të disa vendeve mesdhetare, që edhe sot nuk pushojnë së andëruari si qëmoti. Thoshte David Hume: Njeriu nuk ngopet së radhituri prova që i mendon në favor të pasioneve dhe paragjykimeve nacionaliste të tij (1776).

Ka kaluar një shekull nga dëgjia e Frashërit, nga persekutimi i çamëve, nga shkatërrimet e plaçkitjet në jugun e Shqipërisë, nga vrasjet e përdhunimet e panumërta nga ana e shovinisteve greke. Dhe asnjëherë shoqëria shqiptare nuk i ka dënuar në dritën e diellit dhe me vendosmëri ato krime e grabitje. Në ato vite Mit'hat Frashëri, ambasador në Athinë, dokumentoi dhe denoncoi brenda dhe jashtë kufijve ato forma mizore të genocidit ndaj popullsisë çame. Është kjo arsyeja që populli nuk i harron; sepse plagët duan dritën për t'u shëruar, sepse nga drita vjen edhe drejtësia e me drejtësinë gjejmë të vërtetën.

J.H.Poincaré në veprën e tij më të shquar "Vlera e shkencës" (1905), trajton problemin themelore të shkencave në hapësirën mes matematikës dhe kërkimit shkencor në përgjithësi. Duke analizuar kuptimin mbi objektivitetin e shkencës, ai shkruan: "Objektiviteti vjen nga mundësia për të komunikuar përmes arsytimit që krijojnë ndjesira të perceptueshme nga të gjithë." Nuk ka objektivitet pa komunikim e pa dialog të arsyetuar; ajo që arrin të komunikohet me qartësinë e së vërtetës, shndërrohet në relacion, në marrëdhënie pozitive.

Pra, po të shohim këto pa-



rime në sferën e shkencave historike dhe, më mirë akoma, në fushën e marrëdhënieve ndërmjet popujve, mes individëve deri edhe ndërmjet teorie divergjente, atëherë nevojta për të krijuar dialog real në komunikim, është jetike.

FEJA NUK IDENTIFIKOHET ME KOMBIN

Rilindësit shqiptarë kanë analizuar e theksuar rrezikun që vjen nga nacionalshevinizmat e Ballkanit. Kur andartët greke iu turrrën jugut të Shqipërisë, në krye të synimeve të tyre ishin vendet nga buronte zgjimi dhe drita e shqiptarëve. Frashëri i dritës dhe Kolonja e shkollave shqipe ishin në krye të listës.

Po t'i referohemi studiuesit patriot Dr.Nuri Dragoi në tezën e tij të doktoraturës, gjejmë një thesar më të dhëna të dokumentuara. Burimet e tij janë jashtëzakonisht të plota e të shumëanëshme, në horizontin kombëtar e atë evropian. Burimet e këtij studiuesi patriot janë të pamëshirëshme, ato të lenë me gojë hapur e të shtangin për mizorinë dhe paturpësinë e krimeve që andartët kryen në jugun e Shqipërisë. Turp që ata hiqen sikur të jenë grekë. Qytetarët shqiptarë e grekë kanë jetuar në mjira vjet në harmoni me njëri tjetri. Kjo paqe e harmoni është tjetërsuar nga propaganda e shfrenuar shoviniste e nacionaliste, nga ideja reaksionare që identifikon fenë me kombin e që në tre-

vat e Ballkanit ashtë përkrahur nga qarqet më reaksionare të shovinizmeve greke e serbe në çdo kohë e në çdo rrethanë historike që ata kanë quajtur të përshatshme. Identifikimi i fesë me kombësinë më sjell ndërmend fundamentalizmat arkaikë të botës islame, aq të rrezikshme, e që nuk kanë asgjë të përbashkët me thelbin e identitetit evropian.

Sa ka ndodhur ndër popujt e Ballkanit në shekullin e fundit, e jo vetëm në këtë periudhë, nuk mund të lihet në harresë. Kjo bindje gjen arsyen në faktin që dhuna e padrejtësitë që një kolektivitet ushtron mbi një tjetër, është nja nga format e së keqes. Rreth këtij koncepti dhe pamjeve reale të tij ka një letëratyrë të pafundme filozofike, vepra letrare dhe krijime të arteve figurative. E kemi detyrë kundrejt historisë dhe ndaj të vërtetës ta kuptojmë sa më mirë këtë pamje të jetës kolektive deri në marrëdhëniet mes kombeve.

Historiani dhe filozofi gjerman George Lachmann Mosse në librin "Racizmi në Europë nga origjina deri te Holokausti", kërkon të kujtojë si lindin idetë dhe qëndrimet raciste. Sipas tij, që në lashtësi, ndenja fetare shpeshherë integrohej në racizëm, si një përbërës i shpirtit racit. Madje ai shkoi edhe më tej: konceptimi i Perëndisë dhe i njeriut në frymën iluministe, ndikuan në lindjen e racizmit. Si erdhi kjo?

Iluminizmi, fillimisht në





Angli, edhe pse kundër fesë në format dogmatike të saj, pati nevojë për autoritetin e Zotit për të mbajtur në udhë, në frë njeriun, moralin dhe universin kulturor në përgjithësi. Ky ishte Deizmi anglez që nxiti kërkimin shkencor në hapësirën ndërmjet Njeriut dhe Natyrës, pra të thellonte kuptimin mbi raportin mes Njeriut dhe gjithëqkaje që përcakton ekzistencën e tij. Në një farë mase, ky kuptim disi i errët, e kushtëzonte lirinë intelektuale të Njeriut.

Rilindasit tanë kuptuan që interpretimet e gabuara të Njeriut të kushtëzuar nga Universi kulturor e fetar sjellin shovinizmin. Këtë rrezik e shprehën qartë në veprat e tyre Vaso Pasha, Samie Naim Frashëri, Gjergj Fishta, Marin Sirdani, etj. Ata, si në traditën e kombit shqiptar, kanë paralajmëruar rreziqet që vinë nga identifikimi i fesë me kombin dhe që ky identifikim krijon shovinizmin. Pikërisht kjo pavarësi e thelbit të identitetit të kombit nga besimi fetar i tij, përbën nja nga format më të ndritura të laicizmit, që ka karakterizuar mendimin filozofik të Rilindjes Kombëtare.

GPUHA ËSHTË MBIJETESA E KOMBIT

Në shumë raste ndër popujt e Ballkanit, shovinizmi ka manipuluar problemin e gjuhës.

Filozofi gjerman, J.G.Herder, ka dhënë një kontribut të madh në studimin e rolit të gjuhës në iden-

titetin e një kombi. Ai me termin Volksgelst paraqit botëkuptimin, frymën, shpirtin e një kombi. Karakteri i një populli, sipas tij, shprehet nëpërmjet kësaj fryme kombëtare. Ajo që i jep unitet dhe vitalitet kulturës së një populli është ruajtja e frymës origjinale dhe traditave kulturore që përbëjnë linfën dhe energjinë jetëdhënëse të tij. Nga kjo linfë burojnë parimet udhëheqëse në jetën e kombit. Mbijetesa dhe forcimi i tij kërkon që ajo linfë dhe parimet që burojnë prej saj të ruhen si të shenjta gjatë evolucionit të kombit e kulturës së tij. Përndryshe ai komb ashtë i destinuar të zhduket. Kjo ide shpjegon pse shovinizmi grek ka dashur të shuajë me dhunë e mjete të tjera shkollën shqipe.

Friedrich Müller, filolog e filozof gjerman, themeluesi i studimeve mbi gjuhët indoeuropiane, gjithashtu, konsideronte gjuhën si element thelbësor për të kuptuar shumë pamje të ekzistencës dhe evolucionit të popujve.

Pra, citova këto figura të mëdha të hulumtimit të natyrës njerëzore dhe të kombeve me qëllim që të mos e konsiderojmë si të tepëruar këmbënguljen e rilindasve për rolin e gjuhës jo vetëm në çlirimin kombëtar, por edhe për jetën dhe ekzistencën e kombit në të ardhmen.

Është gjuha ajo që bën Njeriun. Njeriu, si edhe shtazët, ha e fle, pi e çlodhet.



Ajo që e dallon Njeriun është gjuha. Nga kjo vjen komunikimi, arsyetimi dhe, kur janë kushtet, edhe mirëkuptimi. Janë rilindësit ata që i thurën lavde gjuhës shqipe, vargjet e Naimit e të Fishtës, të Mjedës e të Migjenit si dhe bindja e mendimtarëve patriotë të asaj lëvizjeje të madhe filozofike e kulturore.

Çfarë kuptimi mund t'i japim faktit që turku në të gjithë perandorinë ndaloi vetëm hapjen e shkollave të gjuhës shqipe? Nuk e bëri këtë për greqishten dhe as për gjuhët sllave. Pse të ketë ndodhur kjo?

Është e vështirë t'i japim një përgjigje kureshtjes sonë, pra më vjen e natyrshe dëshira të citoj Sami Frashërin: "Sikur elefantin e vrasin për dhëmbët e tij të çmueshëm, guaskën e detit e gjuajnë për margaritarët që kanë e bilbilin e robërojnë

për zërin e tij të bukur, këshu edhe njeriun, të shumtën e herës, e rrezikon vlera e tij e lartë."

Duke analizuar sagën e pafund të hebrejve, Hermann Hesse shkruan: "Urretja kundër çifutëve është kompleks inferioriteti i maskuar." Kundrejt popullit të lashtë e të urtë të çifutëve, disa shtresa më pak të urta të një race tjetër kanë zili që lind nga konkurrenca dhe nga një inferioritet përnjës.

Enjëjta mëri me sa duket ka shkaktuar dyndjet e panumërta kundër Shqipërisë e shqiptarëve, populli më i vjetër i rajonit dhe folës i gjuhës ma të lashtë të Europës.

Rilindësit, veçanërisht Sami Frashëri, Vaso Pasha e më pas Mit'hat Frashëri, Fishta i madh e Mjeda, Noli e Faik Konica, Marin Sirdani e të tjerë u

përpoqën të bëjnë të njohur në botë realitetin historik e kulturor të shqiptarëve, gjë që sot politika as e çon ndërmend.

TE KULTIVOJMË TË VËRTETËN HISTORIKE

George Orwell, eseist i shquar anglez, shkruan: "Kush kontrollon të kaluarën, ka në dorë edhe të ardhmen."

Për këto arsye qarqet shoviniste bëjnë të pamundurën për të deformuar të Vërtetën historike, fjala vjen të bëjnë eshtra të vdekurish për të falsifikuar identitetin e disa varreza apo të shtyjnë njeriun të ndrojë emrin, fakte që opinioni qytetar njej mire dhe ua di kuptimin.

Këto gjëra rilindësit i njihnin, prandaj kanë shkruar për rreziqet që vijnë nga shovinizmat ballkanike. Urtësia e tyre shprehet në aftësinë për të vepruar në mënyrë racionale, duke njohur diferencën mes të Mirës e të Keqes. Naim Frashëri, me gjenialitetin e artistit dhe të filozofit, jep një kuadër të mahnitshëm të luftës mes gënjeshtërisë e të vërtetës dhe na sjell në mendje të keqen që buron nga ky konflikt. Ky ka qenë ngaherë një argument i rrahur në të gjitha kohërat, sepse kur në këtë konflikt mbijeton e Keqja, kjo i hap rrugën padrejtësisë, dhunës e genocidive që shqiptarët i njohin mirë.

Urtësinë që na sjellin veprat e mjeshtrave të gjuhës shqipe, nga Naimi deri te Fishta e Mjeda, e gjejmë në ndërgjegjen e në formimin tonë. Atë nuk e djeg flaka e zjarreve mëkatore të andartëve që hiqeshin për grekë dhe as e ngrin acari i erërave të ftohta që depërtonin veriu - e trojeve shqiptare në kohë të vështira.

Hannah Arendt në veprën "Banaliteti i të Keqes", tregon që njerëzit që kryejnë materialisht krime kundër njerëzimit, janë gënie të indoktrinuar nga mjeshtrit e të Keqes, por jo më pak fajtorë se frymëzuesit e veprës kriminale. Përgjithësisht veprat e filozofes gjermane Arendt theksojnë një mesazh të rëndësishëm: të denoncojmë krimin për të evituar përsëritjen e tyre në të ardhmen. Mendoj që kjo vlen shumë edhe për popujt e mesdheut, këtij djepi të qytetërimit perëndimor.

Pra, janë pambarim figurat që kanë rrëmuar në dobësitë e njeriut dhe të shoqërisë njerëzore për të kuptuar si çfaqet e Keqja dhe si kjo shndërrohet në vepra kriminale.

E vërteta historike lidhet shumë me interpretimin e fakteve kulturore që shpesh mund të ndikohet nga interesa apo pseudoafeksione të natyrës nacionaliste, për të mos folur për forma barbare të shovinizmave moderne. Nga ana tjetër ka edhe

një të vërtetë universale që lidhet me ndjenjat njerëzore, me arsyen dhe objektivitetin që karakterizojnë qënien njerëzore. Sokrati, një martir i të vërtetës u flijua për të mos mohuar thelbin e ndjenjave dhe ideve të tija. Ky thelb ishte e vërteta, e bukura dhe mirësia.


Sa ndodhi në vitin 1914 na trondit edhe sot. Por dua të theksoj që andartët që plaçkitën e dogjën jugun e Shqipërisë nuk janë aspak grekë. Ata e kanë tradhtuar botën helene që nuk bëri luftëra pushtuese, por me vlerën e kulturës e të mendimit filozofik u përhap në të gjithë botën mesdhetare pa futur në valle asnjë ushtar. Historianët helënë dëshmojnë madheshinë e ilitëve, cilësitë karakteriale të tyre.

Në kuadrin e synimeve nacionalshoviniste dhe të një strategjie antinjerëzore, një nga synimet kryesore të andartëve ishte djegia dhe shkatërrimi i qëndrave me tradita patriotike të shquara, mes të cilave printe Frashëri. Po ashtu edhe serbët në vitet '90: duke bombarduar Prizrenin nuk synuan godinat apo dyqanet, por Shtëpinë Muze të Lidhjes së Prizrenit, simbolin kryesor të një periudhe të rëndësishme historike. Pra, shovinistët kanë synuar ta falsifikojnë historinë.

Më lejoni të shpreh mendimin që në 1914 andartët nuk e kuptuan që Frashërit nuk mundën t'i bëjnë as edhe një gërvishjtje. Kënaqësia e tyre ishte e vobekët e mediokre si dhe ata vetë. Pse shpreh këtë bindjeje Frashëri, Prizreni, Shkodra e Korça shihen si vatra të poezisë, gjuhës shqipe dhe identitetit kombëtar. Këto vlera nuk mund të digjeshin dhe as të veniteshin nga barbarizma e andartëve shoviniste. Vepra e Rilindjes ka qenë dhe është në shpirtin dhe mendjen e shqiptarëve.

Për trashëgiminë kulturore, filozofike e historike të rilindasve, duhet treguar kujdesi i merituar nga klasa politike dhe të mos dobësohet roli i saj deri dhe në procesin e edukimit në shkollë. Kjo nuk ashtë një ide abstrakte, por përbën një problem të madh të kombit. Shpreh bindjen që indiferenca ndaj trashëgimisë rilindase do të kishte pasojë më të hidhura se ato të vitit 1914. Opinioni i botës shkencore e kulturore të shoqërisë duhet të shndërrohet në limfë të veprimit të klasës politike. Ajo me sa duket ende nuk e ka asimiluar plotësisht domethënien dhe rëndësinë jetike të ideve që shprehin identitetit kombëtar dhe universi filozofik e kulturor i Rilindjes sonë.

Kjo, më parë duhet kuptuar e pastaj duhet sendërtuar për të mirën e brezave që do të vijnë dhe për dinjitetin e tyre.



DOSSIER

Jeta e martirizuar e biznesmenit Ramadan Zdrava, i cili simpatizoi dhe ndihmoi Lëvizjen Nacionalçlirimtare, por menjëherë pas hipjes në pushtet të PKSH, ai bashkë me familjen vuajtën si të kishin bërë të kundërtën.

Si u sponsorizua Enver Hoxha të krijonte parti nacional-socialiste, jo komuniste

Ylli Polovina

Ramadan Zdrava ishte njëri prej atyre pa triska Fronti, pra të "deklasuara" politikisht nga "diktatura e proletarietit", të cilët ndjenë gëzim që më në fund në 1961 Shqipëria u nda prej Bashkimit Sovjetik dhe madje kreu me këtë rast edhe një hap shumë të kurajshëm: doli nga Traktati i Varshavës.


Gëzimin e singërtë të ndarjes nga "kampi socialist", duke u mundur ta mbajë brenda vetes për të mos u dukur lëpirës i regjimit, Ramadan Zdrava ia shprehu shokut të tij të punës (bënin të dy nxjerrje zhavorri buzë lumit Osum). Ky, N. F., që komunist dhe ishte ai që i tha i pari: "Dane, e more vesh? Dualëm nga Traktati i Varshavës". Tjetri iu përgjigj çiltër: "Mu lumtë! Janë treguar me të vërtetë burra!" N.F. vijoi: "Po si do t'i vejë halli më tutje?" "Shumë më mirë do të jemi", iu përgjigj Ramadan Zdrava, sërisht çiltër.

Këto fjalë të njeriut të dënuar që që pa triska Fronti, N. F. i raportoi në Komitetin e Partisë të Beratit dhe këtu, që prej sekretarit të parë ato rendën drejt Komitetit Qendror të PPSH-së në Tiranë. Ish-te dëshmi e fortë se si për gjestin e guximshëm kundër paktit ushtarak prosovjetik udhëheqja komuniste që vlerësoar edhe prej armiqve të saj politikë.

Nuk kaloi shumë kohë, jemi në vitin 1969, kur në prani të sekretarit të parë të partisë për rrethin, Jordan Pani, u bë në gjimnazin "Ajet Xhindole" mbledhja e organizatës së rinisë së klasës ku ndodhej njëri nga djemtë e Ramadan Zdravës: Asllani. Do të zgjidhej udhëheqja e saj dhe disa prej të rinjve shprehën simpati për të. Mësuesi, i cili që njëkohësisht edhe njëri nga drejtuesit kryesorë të rinisë së shkollës, për të parandaluar çdo vlerësim të mëtejshëm pozitiv të Asllanit, i cili për nga natyra vërtet që mjaft i shoqërueshëm dhe inteligjent, një tip "lideri", u rekomandoi shokëve të klasës të mos shoqëroheshin aq shumë me bashkëmohsharin e tyre. U kujtoi se ai vinte nga një familje e deklasuara. Pas kësaj J. P. ndërhyri e shtoi se "në gjirin e organizatës së rinisë ka mjaft të rinj e të reja nga klasa punëtorë e fshatare, të cilët meritojnë të jenë në krye të saj".

Vijimi i kësaj historie do të kulmonte të nesërmen, në Komitetin e Rinisë së Rrethit, ku Asllan Zdravën e përjashtuan dhe atyre që i kishin shprehur simpati, iu dha parajllim. Tashmë i por-sapërrashuari edhe nga Organi-

Miqësia e Zdravës me Nexhmije Xhuglinin, ajo i tha: "Për ç'ka të kesh nevojë, më shkruaj!"



Sulejman Zdrava, 1913

zata e Rinisë, ndërsa edhe ka goditje të papritura do t'ia kishin tronditur qëndresën psikologjike, iu nënshtrua një traume tjetër. Këtë herë që një oficer i degës së Punëve të Brendshme, i cili e thirri në zyrë. Ky, duke e tingëlluar zërin si të ishte në një miting, i tha: "Je nip i tradhtarit Sul Zdrava dhe i armikut të popullit Ramadan Zdrava". Pa e lënë të merre frymë, e akuzoi menjëherë se në klasë, në prani të vetë sekretarit të parë të Partisë për rrethin e Beratit, kish-te kryer tinëzish një puç për t'u zgjedhur në krye të organizatës së rinisë. "Këtë e ke bërë, mëshoi fjalët operativi i Degës, duke ua mbajtur fshehur se familja tënde nuk ka qenë dhe nuk është anëtare e Frontit".

I DESHIRUARI

Gjatë viteve të luftës që një kapitalist i vërtetë, nga më premtuesit për biznes. Shtatlatë dhe shumë i pashëm, me një pjesë të kohës kaluar në Itali (atje madje i kërkuar për të luajtur një rol në një film), Ramadan Zdrava që i pëlqyer edhe nga elita e grave aristokratë të Tiranës, prej studenteve po ashtu. Kjo ndodhi sepse ai çeli në një qendër të Tiranës, pranë Sahatit, edhe një sallon mode.

Kur pa se të riut nga tronditja po i dridheshin buzët, oficeri befas e zbuti zërin dhe shtoi se megjithatë ai, siç i kishin thënë, që një nxënësi i disiplinuar dhe me rezultate të mira në mësim. Pastaj shtoi: "Partia kërkon të kontribuosh në mbrojtjen e atdheut". "E kam për detyrë këtë", iu përgjigj gjashtëmbëdhjetëvjeçari Asllan Zdrava pa e shkuar fare ndërmend ku do të dilte tjetri. "Vetëm këtë të kërkojmë", shqiptoi oficeri i Sigurimit. Hezitimit të të riut, pasi i nxori para një fletë, i kundërvuri fjalët: "Prandaj firmos!".

Një dialog i shurdhët, ku u shkëmbyen edhe replika, zgjati pothuaj dy orë, derisa Asllan Zdrava iu bind arsyetimit të vet se për mbrojtjen e Shqipërisë, siç përherë kishin bërë të parët e tij, do të jepte jetën. Pra, përse të mos firmoste. Gjithsesi kur doli nga zyra e operativit nuk dallonte dot më ku po i shkelnin këmbët. Kur kaloi para kinemasë së qytetit dhe pa përballë tërë shtatin e lartë shkëmbor e shumë të pjerrët të Kalasë, në kokë i kërcëu mendimi se duhej të ngjitej në pikën e saj më të lartë, tek Tabja Çekbeni, dhe të hidhej poshtë, në humnerën 183 metra. Por menjëherë iu duk sikur e thirri një zë: Thuaj më së pari babait!

Ramadan Zdrava sa e pa të prishur në fytyrë e pyeti çfarë i kishte ngjarë. Pasi e dëgjoi, i tha fjalët qetësuese: "Këtë punë kanë ata, s'je as i pari as i fundit!". "Baba, ti si do të bëje?", e pyeti zëdridhur gjashtëmbëdhjetë vjeçari. Përgjigja e Danit që akoma më shumë brengfashitëse: "Mos iu përgjigj takimeve. Çfarë do të bëjnë? Asgjë".

I ATI ZOGIST, POR E SHPËTOI RIZA CEROVËN

Stërgjyshi i Asllanit quhej Ramadan Ibrahim Zdrava dhe në shpalljen e Pavarësisë në Vlorë që shoqërues jetëruajtës i Aqif Pashë Elbasanit. Gjyshi i Asllanit quhej Sulejman, shkurtimisht Sula. Ky bëri emër më të madh mes të gjithë Zdravajve. Mori pjesë në mbrojtjen e Shkodrës, 1913, dhe deri në ditët e sotme kanë mbërritur nga kjo bëmë e tij çfarë pati treguar e shoqja, Qamilja. Dy javët e fundit të kësaj lufte, rëfente ajo, mbrojtësve ju munguan jo vetëm ushqimet, por edhe uji për të pirë. Megjithatë më shumë se të shuanin etjen e ftohjin trupat e tyre, luftëtarëve u duhej të ftohjin armët, të cilët nga nxehtëja e tepërt bllokoheshin. Në mungesë të ujit për këto të fundit përdornin qepët. Kështu ndodhi që një pjesë e luftëtarëve vdiqën thjesht prej urisë dhe etjes. Kur pas mar-

rëveshjes forcat kombëtare mbrojtëse u lanë malazezëve Shkodrën, qenë aq të uritur, sa kur populli në rrethina, tek iknin për në qytetet e fshatrat e tyre, i pritë me dashuri dhe u ofroi ushqim, disa i zuri buka dhe vdiqën rrugës. Pa mbërritur dot në shtëpi.

Sul Zdrava u ndesh edhe me një armik tjetër: andartët grekë. Këta patën shkelur tërë jugun dhe më në fund kishin hyrë në Berat. Atëherë ai në krye të çetës vullnetare të Dumresë u nis për t'i dëbuar nga trojet amtare. Bashkë me shumë të tjerë bashkëkombës ia doli. Po ashtu edhe kur e kreu për herë të dytë këtë vepër: në 1917. Si pas avokatit Ymer Janina, në bahçen e tij në lagjen Murat Çelbi të Beratit, ky kish parë Sul Zdravën, të veshur me xhidh dhe në dorë një patickë, tek shtinte pa pushim dhe pa u tutur mbi andartët.

Një episod tjetër sërisht nuk do të harrohej mes beratasve: kur këta andartë hynin nëpër shtëpi-rra i urdhëruan gratë të hiqnin unazat, vathët e varësjet. Kush refuzonte kërcënohej me prerje gishi. Përveç se poshtë në qytet, kjo dhunë u krye edhe sipër: në qytetin e vjetër, në Kala. Kur luftëtarët e Sulës bashkë e njësi të tjera kombëtare, i ndoqn rebelët grekë deri përtej Përmetit, tek Tre Urat i çarmatosën dhe u zunë çfarë patën grabitur. Pas luftimeve Sula u kthye në Kala dhe ua ktheu të gjitha stollitë grave. Këto morën secila të vetat dhe në fund vunë re se nuk mungonte asnjë.

Sulejmani bëri karrierë të dukshme ushtarake veçanërisht në kohën e monarkisë. Qe shumë besnik i Ahmet Zogut. Shërbimin ndaj tij e konsideronte si ndaj vetë Atidheut. Prej kësaj ideje që kish-te, edhe pse pati dalë në pension, mori pjesë aktive në shtypjen e egër të kryengritjes së Fierit. Këtë zell komunistë nuk do t'ia falnin pas vitit 1944, pa ditur gjithsesi edhe një hollësi: kur Zogu u ngarkoi për të arrestuar Riza Cerovën, Sula ia "hodhi", bëri sikur nuk e kapi dot. I hapi shteg.

Në të vërtetë kohë më parë, një natë, gjatë një shërbimi ushtarak, pati fjetur tek shtëpia e tij (Rizai nuk qëllloi të ishte) dhe që prej këtij çasti nëna e Cerovës do të thoshte kudo hapur se Sulën e kishte djalë, nëlloj si të birin. Rizanë më vonë, pas shtypjes së kryengritjes së Fierit, do ta vrisnin në pritë në krahinën e Korçës të tjerë ushtarakë të mbretit dhe kur pas kësaj Ahmet Zogut do t'i shkonte fjala se Sul Zdrava e pati tradhtuar, ky e thirri dhe dëgjoi i qetë përgjigjen e besnikut: "Nuk mund ta bëja këtë detyrë, sepse kam ngrënë bukë e



Ramadan Zdrava

kam fjetur në shtëpinë e tij". Zylyftar Zaloshnja, i shpallur nga komunisti Hero i Popullit, antifetardal i papërmbytur, kur do të rastiste, gjatë vetë regjimit, të shprehej për shpalljen që i kishin bërë Sulejman Zdravës si tradhtar dhe armik, do të thoshte pa druajtje fjalinë e shkoqur: "Është i tillë po aq sa jam edhe unë".

Kur hyri 29 nëntori 1944 Sula pati dalë matanë kufirit dhe në tokën italiane, ku zbankoi, por u konsiderua nga anglezët kolaboracionist. Kështu u trajtua si rob lufte dhe u mbajt i izoluar kryesisht në kampin e Rexhio-Emiljas. Këtu në vitin 1950 ndërroi jetë. Kur në gusht 2009 familjarët ia kërkuan në këtë qytet eshtrat, nëpunësit e territorit u justifikuan se në Rexhio-Emilia nuk kishin pasur lista të veçanta për robërit e luftës. Kështu kockat e patretura jo vetëm nuk ia gjetën, por nuk ekzistonte emër i tij as në regjistrat e të vdekurve të popullatës vendase.


KAPITALISTI I "KUQ"

Kur po ikte nga Shqipëria Sule-

jman Zdrava thirri të birin e i tha: "Eja me mua, sepse këta do të bëjnë kurban". Ramadanin ia ktheu: "Unë kam punuar shumë për këta. Ti e di, kam shumë shok e miq, të cilët kanë detyrime dhe nuk besoj se do të më lënë në balte".

I biri po thoshte të vërtetën. Bashkë me të birin, Ramadanin, edhe vetë Sulejmani kish blerë e furnizuar me 1200 pushkë jo vetëm çetat territoriale nacionaliste dhe balliste, por edhe ato partizane. Ramadanin edhe më shumë: qe sponsor i veshjes së Brigadës 25 Sultmuete të porsaformuar. Ai nuk e kishte pushuar përkrahjen për Lëvizjen Nacionalçlirimtare edhe pas prishjes së marrëveshjes së Mukjes, gjë që e kishte alarmuar të atin. Sula tashmë e quante të "Kuq" dhe e pati kërcënuar se do ta shpallte në dy gazeta që nuk e kishte më bir të vet. Dy herë komanda e Ballit në Tiranë pati shkuar për ta arrestuar Ramadanin si përkrahës të LNÇI, por meqë ishte i biri i tij, e patën liruar.

Jeta e Zdravës së ri ishte një çudi



Mosdhënia e triskave të frontit të Asllan Zdravës

I DENUARI

"Je bërë pishman?" e pyeti. "Po, vetëm për një gjë: që nuk ju luftova, por ju ndihmova". "Me atë kokëfortësi që ke, je mirë aty, por çfarë t'i bëj familjes tënde!" Pastaj urdhëroi gardianët: "Qetheni, pastrojeni, visheni dhe në qoftë se ka lekë të tija në drejtori, i blihi ushqime!"



Ramadan Zdrava, qytetar nderi i Beratit



Asllan Zdrava

e pamundur edhe për t'u fantazuar. Kishte qenë fillimisht e një ushtaraku marine, shkolluar në Napoli, por më pas u përkushtua sipërmarrjes ekonomike. Që në motin 1923 kishte sjellë aparatën e parë për filmshfaqje në Berat, ngritur madje edhe një kinema të vogël, në vijim përhapri gramafonin dhe radion. Pastaj makina bloje, shirëseje, motopompa për vaditje, i mor me tregtim manufakturë në Berat e Lushnjë, duke mbërritur më vonë edhe në Tiranë. Këtu tek Pazarit i Ri mori me qira dy dyqane. Ndërkohë që në 1939 në qytetin e Durrësit u bë ortak me Rifat Deliallisin dhe formuan shoqërinë "Zdrava & Deliallisi".

Gjatë viteve të luftës qe një kapitalist i vërtetë, nga më premtuesit për biznes. Shtatëdhjetë dhe shumë i pashëm, me një pjesë të kohës kaluar në Itali (atje madje i kërkuar për të luajtur një rol në një film), Ramadan Zdrava qe i pëlqyer edhe nga elita e grave aristokratë të Tiranës, prej studenteve po ashtu. Kjo ndodhi sepse ai peli në qendër të Tiranës, pranë Sahatit, edhe një Sallon Modë. Më shumë se shijt e Romës ai përhapte atje ato të Parisit. Ky Sallon ish-

te edhe një parlament i vogël, ku bëheshin mjaft biseda politike. Madje një ditë aty erdhi edhe vetë Xhafer Deva me një person tjetër: Ishin nervozë dhe kishin nëpër duar listën e 4 shkurtit. Diskutimin për goditjen, por ende dukeshin të lëkundur. Më në fund Deva e preu: "Më vjen keq për rininë e tyre, por ndryshe Shqipëria po shkon në komunizëm".

Sipas dëshmisë së vetë Ramadan Zdravës, në listën e hakmarrjes qe edhe një e njohur e tij, Nexhmije Xhunglini, të cilës i njihte familjen. Menjëherë dërgoi, me një shegert të tij, një letër tek e ëma e Xhunglinit që ta largonte sa më shpejt të bëjën. Pas mbarimit të luftës Nexhmija, tashmë Hoxha, i erdhi në Sallonin e Modës dhe e falënderoi posaçërisht. Pasi pinë kafë dhe biseduan pak, Ramadanin e përcollti deri tek Ura e Lanës. Kur u ndanë ajo i tha: "Për çka të kesh nevojë më shkruaj!"

Tërë jeta e tij e mëvonshme, deri sa ndërroi jetë, qe vetëm nevojë urgjente për të shpëtuar nga dhuna pa din e iman që i bënte, por ai nuk i shkroi kurrë Nexhmije Hoxhës. Ai e kish këtë të drejtë edhe sepse bashkë me Bahri Omarin

dhe të tjerë, tre tregtarë shkodranë po ashtu, sponsorizuan hapjen e klubit "Flora" në Tiranë, me qëllim që Enveri si djalë intelektual e i pashëm të krijonte një parti të majtë Nacional Socialiste, jo komuniste. Në këtë Klub pihesh duhan e kafë pa paguar. Por historia rrodhi ndryshe: Hoxha për të plotësuar ambicijen e tij gjeti një parti tjetër, atë staliniste.

PROJEKTI PARTIE PËR ENVER HOXHËN...

Në 1945 familja Zdrava, për shkak të arratisjes së Sulës, u internua në Krujë. Në 1946 mbi Ramadanin u vendos një shumë e papërbalueshme si tatim i jashtëzakonshëm. Pagoi pjesën dërmuese, por u lëshua urdhër arresti, fillimisht mbi të atin. Ky qe arratisur. Atëherë në mars i vunë prangat atij. Iu tha familjes se do të merrej për vetëm një sqarim. Nuk e mbajtën fjalën. Para hetuesve të pavendosur ta akuzonin pa prova, siç qe porosia politike, për tentativë rrëzim pushteti, më në fund i gjetën një arnim: Je bashkëpunëtor me Grupin e Deputetëve; çfarë ke biseduar me Gjergj Kokoshin, Loni Plumbin, Sheh Karbunarën; po më parë me Bahri Omarin? Hetuesit ndërhoreshin pa marrë rezultate të manovrës së tyre. Kështu nisën torturat. Më në fund Ramadan Zdravës iu bë gjyqi. P. H., që e drejtonte atë, i dha 7 vjet heqje lirie. Ramadanit kundërshtoi: "Nuk po kuptoj, përse po më dënoni?" P. H.: "Ke bërë tregti me fashizmin dhe ke shumë kapitale jashtë. Ke qëndruar këtu për të minuar pushtetin popullor". E transferuan në burgun e Korçës, i cili qe bërë qendra e grumbullimit të elitës nacionaliste dhe e ushtrimit mbi të të një dhune të tmerrshme.

Qelia e akullt ku rrinte Ramadan Zdrava, pikonte ujë dhe në qendër të saj qe krijuar një pellg të ngrirë. Çdo ditë, duke ia flakur nga sporteli, i sillnin vetëm një pjatë supe. Ajo derdhej në dysheme dhe ai nga uria detyrohej të lëpinte kokrrat e orizit. Shtatë muaj kështu. Më në fund dënimi përfundimtar: me pushkatim. Akuza e re: ke bashkëpunuar me organizatën e Vorio-Epirit. Ditën kur, hipur në dy kamionë, gjithë të dënuarit me pushkatim i nisën për tek vendi i fshehtë i vrasjes, ende pa kapërcyer postoblokun e burgut, përballë u shfaq një "Xhips" i Ministrisë së Brendshme. Ardhësit i ndalën dy makinat me të dënuarit dhe i kthyen mbrapsht. Pushkatimi qe pezulluar deri në një urdhër të dytë. Më vonë Ramadan Zdrava dhe të tjerët e mbyllur në burgun e Korçës, morën vesh se Koçi Xoxe ishte shkarkuar.

E ëma e Ramadanit dhe tërë familja tashmë qenë në alarm, nuk dinin ku ndodhej. Shkuan në Tiranë tek Nevzat Haznetari, zëvendës ministër i Brendshëm. Ky nuk lëkundë: është tradhtar. Kur pas disa ditësh shkoi në burgun e Korçës për inspektim Ramadan Zdravën e gjeti një grumbull kockash që nuk qëndronin në këmbë, me morra nëpër tërë trupin dhe mjekër e paruar gati dy pëllëmbë. "Je bërë pishman?" e pyeti. "Po, vetëm për një gjë: që nuk ju luftova, por ju ndihmova". "Me atë kokëfortësi që ke, je mirë aty, por çfarë t'i bëj familjes tënde!" Pastaj urdhëroi gardianët: "Qetheni, pastrojeni, visheni dhe në qoftë se ka lekë të tija në drejtori, i blihi ushqime!"

Opinion i Ditës

Në këta 74 vjet "pushtim", nga vetvetja, nga e majta, edhe sot, ashtu si më 29 nëntor 1944, vendi ynë, ndoshta prej Zotit më i pasuri në Evropë, ka, nga mendje dhe duar shqiptare, edhe popullin më të varfër në kontinent.

74 vjet çlirim nga fashizmi dhe "pushtim" nga ...vetvetja

Nga Xhevat Mustafa

(vijon nga faqja 1)

... "ramë nga shiu në breshër", nga një pushtim i huaj në pushtimin prej "vetvetes", nga "e majta", përfaqësuar jo nga "ajka" e saj, por nga pjesa më e padenjë, më e paskrupullt, më antinjerëzore, internacionaliste deri në antikombëtarizëm, përsëri kjo datë na ka mbetur në derë si festë, nga Enver Hoxha. Për të qenë objektivë dhe mirënjohës ndaj atyre që luftuan dhe ranë dëshmorë për liri, pavarësi, demokraci, për jetë shumë më të mirë për atë kohë e në të ardhmen, nuk është as e drejtë dhe as shkencore që të kundërshtohet dhe minimizohet lufta kundër pushtuesve fashistë e nazistë dhe "fruti jetëshkurtër", që ajo solli.

Po kështu, nuk është as e saktë dhe as historikisht e dokumentuar se partizanët që dolën të gjallë nga kjo luftë dhe ata që u vranë, luftuan dhe ranë për PKSH-në dhe Enver Hoxhën. As për komunistin dhe socializmin, ku do të "hanin me lugë të florinjta". As për "t'ia rikthyer Kosovën, në emër të internacionalizmit proletar, Jugosllavisë "vendit tonë" në republikë të shtatë të saj. Personalisht, mendoj se këto janë akte të qarta tradhtie kombëtare. Pra, "Balli" dhe "Legaliteti", përfshirë edhe Mid'hat Frashërin, mes dy të këqijave, mes pushtuesve kalimtarë, për 4-5 vjet dhe pushtuesve dhe armiqve qindravjeçarë, serbëve, zgjodhën alternativën e parë. Atëherë, cilët kanë gabuar më shumë? Ata, që gabuan për vetëm 5 vjet apo ai që "gaboi" për 45 vjet? Dashuria, besnikëria dhe nostalgjia për Enver Hoxhën dhe sistemin e tij diktatorial, të ndeshura edhe sot e kësaj dite tek jo pak të majtë, shprehin jo vetëm këmbëngulje për vetëshkallërim ideologjik e politik, por edhe të këqia të tjera jo vetëm për ata individualisht e si familje... Shprehet prej një kohë të gjatë se enveristët kapen fort tek disa alibi, karta apo "fije bari". E para, sipas gjykimit tim, është mirënjohja për shumçka kanë arritur gjatë viteve të regjimit enverian, kryesisht ata që sot janë në moshat rreth 60-85 vjeçare. Këta, përgjithësisht, ndihen borxhlinj të përjetshëm ndaj PKSH-së, PPSH-së, PSSH-së, sepse "sistemi komunisto-socialist", menjëherë pas luftës apo më vonë, i mori nga fshatrat dhe krahinat e tyre dhe i solli në Tiranë dhe në qytetet e tjera. Këtu u bënë më shkolla të mesme e të larta në Shqipëri dhe në vendet e Kampit Socialist, me zanate e vende pune për vete, gratë dhe fëmijët, me apartamente banimi... Disa që patëm më shumë fat, merita, të njohur apo miq, u bënë edhe kuadro në strukturat partiake, administrative; nëpër ministri, në



industri, miniera, naftë, bujqësi; në arsim, shëndetësi, kulturë; në ushtri, polici, sigurimin e shtetit, drejtësi... Por, në goftë se do të bëhet një analizë e thellë, objektive, e pandikuar nga politika, do të dalë se ata dhe familjet e tyre i kanë dhënë diktaturës komuniste shumë më tepër se sa u ka dhënë ajo.

Nëpërmjet pagave të ulta, mungesave të shumta në tregje e për jetesë normale, keqpërdorimit apo shfrytëzimit barbar të fryteve të punës dhe të djersës së tyre, mungesës së lirive themelore njerëzore dhe demokratike, bëhet e qartë se Enver Hoxha i ka trajtuar dhe shfrytëzuar edhe ata, si shumicën e shqiptarëve, si skllëvër e si "kavie" për eksperimentet e tij të çmendura e çnjerëzore. Regjimi komunist i solli në qytete apo në kryeqytet jo nga dashuria dhe përkujdesja e madhe individuale, krahinore e sociale, por, sepse i duheshin për të zëvendësuar intelektualët dhe kuadrot e diplomuar në universitetet të Evropës Perëndimore, që Enver Hoxha i vrau dhe burgosi për rreth 47 vjet, edhe më shumë nga sa u vranë nga pushtuesit, me dy qëllime. Së pari, për t'i eliminuar këta intelektualë si ura të mundshme ndikimi nga qeveritë e vendeve ku ishin diplomuar dhe të hapjes ekonomike dhe politike ndaj Perëndimit Kapitalist.

Duke qenë se shumica e këtyre intelektualëve vinin nga familjet të pasura e të shquara, Enver Hoxha, edhe nëpërmjet burgosjes së baballarëve, konfiskimit dhe shtetëzimit të pasurive të tyre familjare, arriti të "vriste" jo vetëm politikisht edhe klasën e borgjezisë dhe të djathtët shqiptare, duke e lënë vendin edhe sot e kësaj dite pa të djathtë të vërtetë, gjenetike, të konfiguruar qartë, të konsoliduar, "investim" që po i shërben fort prej më se 5 vjetësh Edi Ramës dhe "rilindjes" së tij, sidomos me sloganin mashtrues "të dy palët janë njësoj". Së dyti, për të krijuar in-

teligjencien e vet, komunisto-socialiste, me nivel të lartë politizimi, besnikërie, partishmërie, militantizmi, kukëllizimi, skllavizimi... Se sa i ka dashur me të vërtetë apo singerisht regjimi komunist dhe personalisht Enver Hoxha mund të kuptohet se pjesa më e madhe e fitimeve nga puna, djersa, mendja dhe sakrificat e tyre të përditshme, shkuan për eksperimentet dështake dhe aventurat qesharake të tij në politikë, ekonomi, industri, mbrojtje, me shprehje të qartë gjigandomanie dhe që nuk ndikuan realisht në rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Ato u orientuan dhe humbën si kripa në ujë kryesisht për shpenzimet e mëdha për ushtrinë dhe mbrojtjen. Kapur tek ky fakt, edhe sot e kësaj dite dëgjon plot enveristë të shprehën me nostalgji se "para 1990-ës kishim ushtri të fortë". Por, "harrojnë" se si u shfrytëzoi si tullumbace, brenda një kohe të shkurtër, para ushtrive amerikane dhe të NATO-s ushtritë e Milosheviçit, të Sadam Hyseinit, Muamar Gadafit...

Në atë kohë, ushtria shqiptare ishte e fortë para popullit të vet, në parada, manovra ushtarake, ku luftonte me vetveten, me armiq të rrezikshëm të sajura nga mendja e sëmure e Enver Hoxhës... Një kartë tjetër "e fortë" e enveristëve të vjetër e të rinj është edhe ajo e "shtetit të fortë në kohën e Enverit". Në të vërtetë, ky ishte shtet personal, njëpartiak dhe diktatorial i fortë, pa mirëqenie, pa liri fjale dhe lëvizjeje, pa drejtësi të pavarur e të depolitizuar, pa avokat mbrojtës... Një tjetër kartë e plot të majtëve, të mësuar keq për rreth 47 vjet pa "të djathtë" dhe "opozitë", fshihet trashë me justifikimin se "Edi Rama vërtetë po na turpëron dhe zhgënjën, por nuk na hyjnë dot në zemër edhe Saliu, Luli dhe PD-ja?! Të gjitha fajet dhe përgjegjësitë për gjendjen mjerane të vendit, edhe sot pas 5 vjetësh, i kërkojnë, gjejnë dhe faturojnë tek

PD-ja, opozita dhe personalisht tek Sali Berisha dhe jo tek qeveritë Rama 1 e 2, mbushur me "diletantë" apo "kalamaj të këqinj", jo tek partia dhe qeveria e tyre, jo tek vetvetja, që i votojnë dhe mbështesin...

74 vjet janë tmerrsisht shumë për t'u bindur se e keqja Shqipërisë i ka ardhur nga e majta, si rrjedhojë edhe e qenies në Lindjen Komunisto-Socialiste dhe në Ballkan, gadishull ku Rusia ka pasur dhe ka interesa të mëdha për ndikim të fortë politik dhe ekonomik. Nuk është e vështirë për të kuptuar se cili grupim apo sistem është me superior, se e majta allashqiptare ka dështuar plotësisht. Këtë e shpreh edhe fakti se shumica e shqiptarëve, ashtu si shumica e qytetarëve nga vendet ish-komunisto-socialiste, përpigën të shkojnë me çdo rrugë e faturre drejt vendeve të Perëndimit kapitalist apo të djathtë, me mundësi të mëdha punësimi, me nivel rreth 10 herë më të lartë për paga, pensione dhe mbështetje sociale...

Këtë fakt e shpreh edhe lëvizja e ushtrive emigratore vetëm nga një kah: nga Lindja drejt Perëndimit. Ose nga gjasme socializmi dhe gjasme kapitalizmi drejt Perëndimit dhe Kapitalizmit të vërtetë, të prekshëm, të përrjetshëm...

Rëndimi dhe masivizimi i varfërisë, papunësisë, pashpresësisë, emigrimit, ulja e lindshmërisë...po sjellin edhe uljen dhe mplakjen e ndjeshme e me ritme të frikshme të popullsisë së vendit tonë, proces që merret me mend se i gëzon fort armiqët tanë shumëshekullorë. Të mos harrojmë në këta 74 vjet "pushtim", nga vetvetja, nga e majta, pra, duke përfshirë tek kjo edhe 13 vjetet e qeverisjes nga Berisha dhe ekipet e tij, me shumë gjasa "pjella in-vitro" të ndonjë klinike në Tiranë, Katovicë e gjetiu, dhe sot, ashtu si më 29 nëntor 1944, vendi ynë, ndoshta prej Zotit më i pasuri në Evropë, ka, nga mendje dhe duar shqiptare, edhe popullin më të varfër në kontinent. Edhe sipas statistikave më të freskëta të INSTAT-it dhe FMN-së kemi pagat dhe pensionet më të ulta e çmimet më të larta të shumicës së ushqimeve, të lëngjeve dhe pijeve, nga uji tek mjalti, të higjienës familjare dhe individuale, të një litri karburant, të një bilete avioni, të një km autostradë, të paketave të celularëve, internetit... Është shumë shprehës fakti, se "komunizmi" erdhi me Enver Hoxhën më 29 nëntor 1944 me triska, "iku" me Ramonë Alinë më 22 mars 1992 me talone e me ushtri emigrantësh dhe po "rilind" nga Edi Rama dhe ekipi i tij, mbi "gërmadhat" edhe të vetë së PS-së, po me varfëri ekstreme e masive dhe me "lumenj" emigrantësh

Opinioni *i* Ditës

Ukrainë: Rreziku nga "lufta totale"

Nga "Deutsche Welle"

(vijon nga faqja 1)

... ka kritikuar Rusinë për grumbullimin e forcave dhe ka shpallur gjendjen e luftës. Cilat janë pasojat ndërkombëtare?

Armata ruse ka grumbulluar shumë tanke dhe pajisje të tjera në afërsi të kufirit me Ukrainën, thotë presidenti ukrainas, Petro Poroshenko. Në kufi është ngritur në mënyrë dramatike dhe numri i njëjësive ushtarake. Ekziston rreziku i një "luftë totale", thotë presidenti ukrainas.

Grubullimi i trupave ruse "përgjatë kufirit tonë" është konfirmuar edhe nga shërbimet sekrete, përon ai. Të dhëna të sakta për numrin e ushtarëve rusë të grumbulluar në afërsi të kufirit me Ukrainën nuk ka. Agjencia ruse e lajmeve "Interfax" njofton se qeveria në Moskë do të dërgojë në Krime edhe sisteme raketore për mbrojtje, Typ S-400. Sistemet do të jenë të gatshme për përdorim deri në fund të vitit.

Trump vë në pikëpyetje takimin me Putinin

Parlamenti i Ukrainës ka ven-



dosur të hënë gjendjen e luftës në kohëzgjatje prej 30 ditësh, në disa pjesë të vendit. Kriza e tanishme në raportet mes Ukrainës dhe Rusisë ka filluar të dielën me konfliktin mes forcave të marinës në Detin e Zi. Forcat ruse kanë qëlluar në afërsi të Krimesë tri anije ushtarake ukrainase. Si pasojë, shumë ushtarë ukrainas janë plagosur, ndërsa 24 pjesëtarë të ekuipazhin janë arrestuar. 12 prej tyre janë dërguar në burgun hetues në

Krime.

Për shkak të krizës më të re në Ukrainë, presidenti amerikan, Donald Trump, është duke menduar të anulojë takimin e parashikuar me presidentin rus, Vladimir Putin, i cili parashikohet të mbahet në kornizat e samitit të G20. Ai po pret një raport të detajuar të shërbimeve amerikane për të vendosur nëse do të takohet me Putinin, tha Trump për gazetën "Washington Post". "Ndoshta nuk

do të takohemi fare. Mua nuk më pëlqen ky agresion, nuk po më pëlqen aspak", tha Trump.

SHBA: Evropianët duhet të mendojnë për furnizimin me gaz rus

Një takim i gjatë mes Putinit dhe Trumpit është parashikuar të mbahet në kornizat e samitit të G20, i cili zhvillohet të premen dhe të shtunën në Buenos Aires. Ata do të bisedojnë për gjendjen e sigurisë, kontrollin e armatimeve, gjendjen në Lindjen e Mesme dhe në Ukrainë - tha John Bolton, këshilltar i presidentit amerikan për siguri.

Njëkohësisht SHBA-të kanë shtuar presionin ndaj Evropës që të rimendojë edhe njëherë çështjen e furnizimit me energji nga Rusia. Ai ka kërkuar ashpërsimin e sanksioneve ndaj Rusisë, me synim mbështetjen e Ukrainës. SHBA e ka halë në sy projektin e gazpërçuesit lindor, i cili do të ndërtohet në bashkëpunim mes sipërmarrjeve ruse dhe evropiane - nën udhëheqjen e Gazpromit. Kundër këtij projekti është deklaruar edhe Ukraina.

Opinioni *i* Ditës

Skënderbeu nderohet në Londër

Nga Erblin Jaku

Vjeshta i ka dhënë të tjera ngjyra Londrës. Ndërtesa të bukura, vende përallorë e gjurmë historie gjenden kudo. Portat hyrëse drejt "Buckingham Palace" qëndrojnë hijerënda! Menjëherë të shfaqet një rrugë e bukur, ku pemët bri saj e gjethet poshtë tyre janë tapeti që të çon drejt shtëpisë së mbretëreshës. Teksa përshkon metrat e para të kësaj shtëitorje historike, në të djathtë shfaqet godina e "British Academy". Ajo sot flet shqip! Brenda saj nderohet heroi më i madh i kombit shqiptar, njeriu që i dha frymë identitetit evropian të shqiptarëve, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Nga Londra, ku për ironi të fatit nuk kanë ardhur gjithmonë lajme të mira për Shqipërinë, nisin festimet ndërkombëtare në nder të heroit tonë në këtë muaj të flamurit kuq e zi. Gjithçka është organizuar nga Anglo "Albanian Association", drejtuar nga historiani i Universitetit të Oksfordit, Sir Noel Malcolm, në bashkëpunim me Ambasadat e Shqipërisë dhe Kosovës në Londër. Mbështetësi kryesor i këtij takimi është "Butrint Foundation", pjesë e "The Rothschild Foundation", themeluar nga lordi Rothschild në vitin 1993.

Sapo hyn në ndërtesën e veçantë të kësaj akademie, mikpritësit të orientojnë drejt një ekspozite të rrallë "Koleksioni i Patricia Nugee". Çfarë mrekulli! Antikuaire,



libra, histori, biografi, drama e shkrime që dëshmojnë përmasat e jashtëzakonshme të një figure si Skënderbeu. Të gjitha këto vepra të botuara para 4-5 shekujsh në vende të ndryshme të botës janë mbledhur e ruajtur me kujdes nga një zonjë, tashmë 80-vjeçare, që dashurinë për Skënderbeun dhe Shqipërinë e ka pasur bashkudhëtare në jetën e saj. Është krenare që sot mbart këtë koleksion të rrallë, që dëshmon se heroi i shqiptarëve ishte dhe është një emër i madh e i respektuar ndër historianë, shkrimtarë e artistë të Europës. Libri më i vjetër i këtij koleksioni i përket vitit 1510, ndërsa më i ri është i vitit 1868.

Salla e madhe e "British Academy" bëhet gati të kumtojë për audiencën e zgjedhur detaje nga his-

toria e jashtëzakonshme e një njeriu që ndihmoi në ruajtjen e paqëndrueshmërisë së Europës gjatë luftërave me Perandorinë Osmane. Aty parakalohet betejet e një njeriu të madh, jeta e një udhëheqësi vizionar dhe kontributi i rrallë, që një njeri i vetëm mund t'i japë historisë botërore. Richard Hodges, president i Universitetit Amerikan në Romë dhe ish-drejtuari i lartë i fondacionit "Butrinti" për 18 vite, foli për lidhjet e Skënderbeut me historinë e trashëgiminë, veçanërisht me gytetin e Butrintit gjatë udhëheqjes së heroit tonë.

Paul Rogan Quarrie, një ekspert i librave të rrallë me një përvojë 40-vjeçare, lektor në "University College London", foli për vlerën e jashtëzakonshme që mbartin bot-

imet për Skënderbeun, këtë frymëzues për njerëzit e letrave dhe artit.

Skënderbeu ishte edhe një strateg i zoti, ushtarakisht dhe politikisht. Për të kuptuar më mirë mënyrën se si ai krijoi aleancat dhe si udhëhoqi Arbërinë për 25 vite, nga Shqipëria kishte ardhur ish-ministri i Jashtëm, historiani Paskal Milo.

E ndërsa shijon një gotë verë shqiptare në zemër të Britanisë, Olsi Qianmi, dirigjent dhe themelues i "London City Philharmonic" prezanton atë që mund të quhet ëmbëlsira e kësaj mbrëmjeje dhe një diamant në kurorën e lavdishme plot krijime artistike për Skënderbeun. Janë dy arie të kompozura nga Vivaldi për Heroin e Kombit Shqiptar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Historia ende nuk e ka zbuluar të gjithë veprën që një nga kompozitorët më të mëdhenj të njerëzimit ka shkruar për Skënderbeun. Ajo sot nuk ekziston e plotë, ka shumë dyshime përse është zhdukur, por ka vetëm një të vërtetë Skënderbeu ishte frymëzim për këtë krijues të rrallë të muzikës, Romina Bace është sopranoja që ka marrë përsipër të performojë ariet e veprës "Scanderbeg", moment që pritet me kërshtëri, shijohet dhe duartrokitet pafund.

Të gjithë janë mbledhur për Gjergj Kastriotin Skënderbeun, për të nderuar lavdinë e tij, për t'u krenuar me madhësinë e kësaj figure që frymëzoi kur jetoj dhe është ende fryma e një kombi.

HOROSKOPI

DASHI

Të gjitha përpjekjet e bëra do kurorëzohen me sukses dhe do ndiheni shumë më mirë se më parë. Në familje do mbizotërojë mirëqenia. Fusha profesionale do jetë gjithë kohës e mbrojtur.

DEMI

Në punë duhet t'i dyfishoni përpjekjet nëse doni të arrini sa më shpejt majat. Në familje mos u tregoni të paduruar. Sektori i financave do jetë përgjithësisht i qetë.

BINJAKET

Në punë do jeni me shumë fat dhe mund të merrni edhe propozime për rritje në detyrë. Gjendja shëndetësore nga ana tjetër nuk do jetë shumë e mirë.

GAFORJA

Në punë do jeni mjaft ambiciozë dhe do mundoheni t'i arrini të gjitha synimet që i kishit vënë vetes. Në familje do keni disa mosmarrëveshje, por pa pasoja.

LUANI

Kjo do të jetë një ditë dinamike dhe shumë kreative. Në përgjithësi do keni arritje të vazhdueshme. DukPëri punën do jetë një periudhë pozitive dhe e mbushur me arritje. Edhe jeta familjare do jetë e qetë.

VIRGJERESHA

Në punë do jeni krijues dhe të gatshëm për të bërë më të mirën vetëm për të arritur atje ku doni. Disa kolegë do ju ndihmojnë. Në familje duhet të tregoheni më mirëkuptues.

PESHORJA

Për shëndetin nuk duhet të shqetësoheni, pasi gjendja ka për të qenë shumë e mirë. Në punë duhet ta dyfishoni përpjekjen. Jo çdo gjë do ju ecë sipas planeve në dashuri.

AKREPI

Beqarët do kenë një ditë të paqëndrueshme dhe shpeshherë do ndihen të përhumbur. Për buxhetin nuk do përkujdeseni shumë, megjithatë fati do jetë me ju.

SHIGJETARI

Buxheti do jetë i qëndrueshëm. Në punë do keni mundësi të mira. Përfitoni nga shansi që ju ofrohet dhe keni për të ecur përpara. Jeta familjare do mbetet e qetë.

BRICJAPI

Shëndeti parashikohet të jetë i shqetësues. Shfrytëzoheni sa më shumë që të mundeni aspektin e mirë planëtar. Me miqtë gjithashtu do keni marrëdhënie të mira.

UJORI

Shëndeti mund të paraqesë disa shqetësime të vogla. Klima në familje do jetë e ngrohtë. Në vendin e punës jvet do kenë ndikim të madh sot për të lindurit në shenjën tuaj.

PESHQIT

Financat do i menaxhoni me shumë kujdes dhe maturi, prandaj gjendja do mbetet e mirë gjatë gjithë kohës. Për shëndetin duhet të keni më shumë vëmendje.

PRESIDENTI I TIRANËS



Nga stërvitja e Tiranës në "Skënder Halili", në një prononcim për Supersport, është presidenti i Tiranës, Refik Halili, i cili ka deklaruar se këtë radhë, më shumë se kurrë të luajnë për ta fituar këtë derbi në një situatë delikate. Ai ka zhvilluar edhe një mbledhje me lojtarët, ku ia ka kërkuar një fitore atyre. "Kemi një ndeshje

Halili: Dua fitoren në derbi, tifozëve u kemi borxh

shumë të rëndësishme me Partizanin. Kemi vite që nuk fitojmë një derbi. Unë jam i qetë. Fitorja do të ishte një gjë shumë pozitive për skuadrën. Kampionati është i gjatë, por tani nuk ka më kohë. Shpresoj që çunat të bëjnë diçka të tillë. Mema edhe pse nuk

ka arritur ende fitoren e parë, jam i kënaqur me punën e tij. Unë ndoshta kam gabuar tek menaxhimi, pasi nuk kam vendosur asnjë gjobë. Nuk është për t'u lavdëruar, por është një ves i imi. Shpresoj që çunat ta kenë kuptuar, pasi kemi shumë

borxhe ndaj këtij klubi. Tifozëve u kërkoj ndjesë, pasi janë tifozëria më e mirë dhe më e shumtë. Ka shumë për të thënë, por tifozët janë të parët. Ata kanë të drejtë, pasi nuk jemi në një moment të mirë dhe i kemi shumë borxhe njerëzve që e kanë ndjekur për vite Tiranë." - u shpreh Halili.

Timonieri i Partizanit shprehet optimist në prag të ndeshjes më të rëndësishme të kampionatit

Gega: Fitorja ndaj Tiranës detyrim, Hoxha nuk luan!

Shoqërimi në rajon, trajneri ul në stol kapitenin



Jeton Selimi

Partizani pret Tiranën në kryendeshjen e javës së 15-të me një objektiv të vetëm, fitoren. Natyrisht që triumfi në derbi është një detyrim më shumë sesa trepikëshi, pasi duke qenë se është ndeshja më e ndjerë në kryeqytet, të dyja skuadrat duan të japin një performancë të mirë për të kënaqur tifozët e tyre. Trajneri Skënder Gega, në konferencën e fundit për shtyp të zhvilluar në prag të takimit kundër Tiranës, tregon se të kuqtë duan suksesin e radhës. "Partizani është një familje e madhe dhe ekipi është i kompletuar. Ekipi është i karikuar dhe do të bëjmë të pamundurën të dhurojmë spektakël dhe të japim atë që tifozët presin prej nesh. Kundërshtarit nuk do t'i hiqja asnjë lojtar. Mjafton që të fitojmë dhe të jemi të sigurt e të kujdesshëm. Besoj se ecuria jonë është ajo që tregon se kush është diferenca. Jemi në vend të parë e kryesues, pavarësisht se kemi bërë tri humbje, kemi treguar se jemi ekip solid, me agresivitet, vrapon 90 minuta, ekip i ndërthurur mirë eksperiencia me të rinjtë. Kjo është diferenca. Jetojmë të dy palët në Tiranë dhe këtu nuk ka diferencë të madhe. Por ky kampionat, kjo fazë ka treguar se ne jemi të parët se e meritojmë. Pjesa tjetër është diferenca mes pikëve". Megjithatë, te Partizani ujerat nuk kanë qenë të qeta. Portieri dhe kapiteni i skuadrës, Alban Hoxha, ka humbur tre ditë stërvitje pasi është gjendur i dehur në timon dhe forcat e rendit e kanë shoqëruar në komisarit. Për trajnerin Gega, gjërat janë të qarta. Hoxha nuk do të luajë në derbi. "Gjërat kanë funksionuar mirë, por ka pasur edhe raste të veçanta që na penguan në ecurinë tonë. Përpara derbit do të donim që Alban Hoxha të ishte në 100%, për më tepër është



edhe kapiten, por si qytetar duhet t'i marrim pak më gjerë këtë. Nuk besoj se do të luajë. Si sportist nuk duhet të ishte në atë vend në atë kohë. Ligji është për të gjithë njësoj. Çdo lojtar e di rregulloren e klubit. Ne flasim çdo ditë dhe sjellja jonë duhet të jetë e kontrolluar. E presim në stërvitje, por klubi ka ligjet dhe kriteret e veta, që Hoxha të ballafaqohet me atë që ka bërë. Kemi kriteret tona, për sjelljet e pahijshme. U ndodh edhe lojtarëve të mëdhenj, por nuk duhet të ndërshëm, kanë temperamenti dhe i tyre. Gjatë ndeshjes në Vlorë ishte jashtëzakonisht korrekt, në dhomat e zhveshjeve ishte

jashtëzakonisht korrekt. Ishte një shembull. Por në 90 minuta nëse je në një ambient të mbyllur, kur ke

2-3 veta që kalojnë kohën duke të sharë, përdorin fjalor jo normal për vende normale, besoj se të shqetë-

son. Çdo gjë që ndodhi pas ndeshjes nuk ka të bëjë fare me shiritin e kapitenit, sepse kemi një grup lojtarësh që janë titullarë dhe kanë një kontribut të jashtëzakonshëm, edhe mes tyre ndryshon temperamenti. Shiriti është i rëndë për disa lojtarë. Performanca tregoi se Trashinuk e ka mendjen të shiriti. Sa i përket vendimit të Komisionit të Disiplinës, nuk i di rregullat dhe ligjet e saj. Kam qenë prezent dhe e di sa e vështirë dhe sa presion është kur një lojtar shahet 90 minuta pa pushuar, duke qenë në fushë e bërë punën e vet. Nuk e kemi çuar ne Trashin te Disiplina, njerëzit e federatës kanë çuar Trashin te Disiplina", -tha ndër të tjera gjatë konferencës së djeshme timonieri i kuq.

FSHF: Do të vazhdojmë punën me Panuçin

Përkundër zërave për ardhjen e një tekniku të ri në krye të Komitetit, FSHF insiston se do vijojë puna me Kristian Panuçin. Institucioni i futbollit nëpërmjet një komunikate për shtyp ka hedhur poshtë të gjithë zërat se ishte vënë në kërkim të një zëvendësuesi. "Nisur nga disa spekulime dhe lajme abuzive që kanë qarkulluar në disa media orë e fundit, Federata Shqiptare e Futbollit dëshiron t'ju informojë se nuk është aspak e vërtetë që jemi në kërkim të një trajneri të ri për Komitetin Shqiptar të Futbollit. FSHF është duke punuar dhe bashkëpunuar maksimalisht me trajnerin Panuçi për të arritur rezultate sa më të larta në kualifikueset për Kampionatin Europian 2020", shkruhet në një komunikatë për shtyp të publikuar sot nga FSHF që duhet t'i japë pak qetësi italianit... të paktën deri në mars kur të fillojnë eliminoret.

Mesfushori kuqezi i Peskarës

Memushaj: Nuk më kënaqin golat, dua rikthimin në Serinë A


Mesfushori i kombëtares shqiptare, Ledian Memushaj po kalon momente të mira me skuadrën e Peskarës në Serie B dhe me golat e asistet e tij, po ndihmon skuadrën italiane të jetë favorite absolute për tu rikthyer në Serie A. Memushaj ka folur për mediat italiane, ku u shpreh se shifrat individuale nuk i interesojnë aspak, por vetëm objektivi final, ai i ngjitet në Serie A: "Nëse do të kishim mundur Askolin, do të ishim ngjitur në krye të renditjes dhe do të parakalonim Palermon, prandaj them se kemi lënë pikë të rëndësishme. Në konsideratë të tjera, mbetemi të qetë, natyrisht. Nuk ishim të aftë të shfrytëzonim superioritetin numerik, pasi Askoli u mbrojti shumë mirë. "Në sezonet e kaluara, këtu në Peskara kam shënuar disa gola dhe kam asistuar shpeshherë shokët e skuadrës, por këto janë vetëm disa statistika dhe numra. Gjëja që ka rëndësi është ngjitja sa më parë në Serie A, aty ku Peskara e meriton të jetë", - u shpreh Memushaj.

Superklasika, presidenti i Riverit provokon rivalitet

D'Onofrio: Bëhuni burra dhe ejani të luajmë futboll

Pas incidenteve të panumërta në prag të finales midis Boka Zhumios edhe River Plejt, përballja midis dy ekepeve është zhvendosur të "luhet" në zyra. Në bashkëpunim me "Commebol" të dy klubet kanë vendosur që sfida të luhet më 8 ose 9 dhjetor, por drejtuesit e skuadrave nuk kanë kursyer polemikat me njëri-tjetrin gjatë orëve të fundit. Kjo ka ndodhur pasi presidenti i Bokas ka dashur që të fitojë ndeshjen në tavolinë 0-3, pas trazirave të shkaktuara nga tifozët e ekipit të Riverit. Gjithsesi nuk mund të mungonte reagimi i presidentit të Riverit, D'Onofrio që është shprehur: "Mjaft u morë me fjalë. Bëhuni burra, duhet të vini për të luajtur. Duhet të mbani fjalën dhe të luani futboll, goftë edhe sikur të shkojmë për të luajtur në hënë". Presidenti i Riverit ka dashur të shmang kështu rastin e ndodhur në vitin 2015 ku pas hyrjes në fushë të tifozëve të Riverit, ekipi i Bokas e mori ndeshjen 3-0 në tavolinë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Një pije freskuese.
7. Graf ish teniste.
12. Dada, ish-diktator i Ugandës.
13. Eshhtë pasuri e investuar.
15. Mund të jenë fetare.
16. Një pjesë e relacionit.
17. Fillojnë ambalazhimin.
19. Një vegël.
20. Qe harkëtar i famshëm i akejve.
24. Fillojnë hetimin.
25. Një atentator vëtvërasës.
26. Kështu janë takimet zyrtare.
29. Eshhtë anije me dy skafte.
31. Fundi i Turandot.
32. Inicialet e Reitman regjisor.
33. Farrell regjisor.
34. Schneider që qe aktoe.
36. Mund të jetë e lirë për hartim.
38. Emri i Pasternak.

39. Ekberg e La dolce vita.
42. Dikur qubej Mediolanum.
43. Ruajnë pa ujë.
44. Një mund të jetë kalendari.
46. Një është meskini, shpirtngushti.
47. Një hidrokarbur.
48. Mund të jetë franceskan.

VERTIKAL

1. Jessica Parker aktoe.
2. Zola shkrimtar.
3. Janë dritë të tilla me parsec.
4. Mund të jenë gjaku.
5. United Kingdom.
6. Eshhtë njeri me principe.
7. Një polimer për kirurgji estetike.
8. Kufizojnë takimet.
9. Diftong teatral.
10. Fillojnë fluturimin.
11. Makina Uno.
14. Eshhtë shpend lagune.
18. Eshhtë operator që bën zoom.
20. Eshhtë i pashpirt.
21. Parashtesë për një.
22. Pak enigmatike
23. Një pjesë e Toskërisë.
25. Agustini ish-bomber.
26. Kufizojnë një princip.
27. Miku i Batman.
28. Tapeti për judo.
29. Janë stadt në videogame.
30. Bëhet një kundër vendimit.
34. Janë me blerim mbuluar në një film
35. Eshhtë shtet aziatik.
37. Papavrami violinist
38. Fadli komik
40. Përshëndetja e Jul Qezarit.
41. Mbyllin fushatat.
42. Me të bëjnë një ketër.
45. Mbyllin një takimim.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Një pemë gjigante.
6. Janë për të kërcyer.
13. Ishë shkolla e Aristotelit
15. Një thirrje me emra.
17. Gjysmë rivale.
18. Një pjesë e narkotikëve.
19. Një tis... mjegulle
20. E famshme ajo e Keopsit
23. Mbyllin një sirtar
24. Eshhtë ngjyrë e... fytyrës.
25. Fillojnë lejen.
26. Janë aktorë kryesorë.
29. Janë kompozime të kënduara.
30. Hudson aktoe.
31. Satelit i Uranit.
32. Fillojnë tatëpjepën.
33. Mbetur në fund.
34. Sapo fillojnë.
35. Kastile janë në fund.
36. Kufij takimi.


38. Ekstremet e tokës.
40. Inicialet e Einstein.
41. Qendër mësimi.
42. Kështu thirrej Marco Pantani.
45. Pak irredentizëm
47. Fundi i një filmi.
48. Popullojnë qytetin.
49. Janë gojë vulkanesh
50. Eshhtë edhe ai Persik.

VERTIKAL


1. Mund të jetë sekrete në derë.
2. Makina Agila.
3. Ami i Maupassant.
4. Mbyllin një sirtar.
5. Rrëzohen me strike
6. Luciano tenor i paharruar.
7. Mbyllin këndet
8. Eshhtë borxh.
9. Mbyllin portat.
10. Hagen rockstar.
11. Një pjesë e akademisë.
12. Bien me ballë.
14. Një barkë lëkurëkuqsh.
16. Aje ku shkon progresisti
20. Pallati i Dalai Lamas në Lhasa
21. Një pjesë e minoritetit.
22. Eshhtë fluturues në ufo.
24. Do të bëhen mace të tilla.
25. Fletë pa kufij.
27. I ka tek rendi.
28. Kreshniku i volejbollit.
29. Një det që është liqen në fakt.
36. As unë, as ai.
37. Në mes të King edhe Cole të muzikës.
39. Një parashtesë zmadhuese.
40. Eshhtë lon papagalli.
41. Titulli i Sean Connery.
42. Fillojnë panikun.
43. Gjysma e rojave.
44. Fitim pa kufij.
46. Mbyllin një sherr.
47. Fillojnë një metodë.
48. Kufizojnë botimet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	R	I	E	K	O	H	A	A	K
F	I	L	L	I	D	O	M	A	T	E
R	A	F	T	M	I	M	R	A	T	I
A	A	P	E	R	I	P	A	T	I	S
N	H	P	A	K	E	T	I	M	E	T
Z	E	M	E	R	A	K	E	T	I	S
F	I	D	A	N	E	T	V	E	T	E
S	E	N	A	T	I	I	B	E	R	I
S	E	N	E	K	A	L	L	A	P	A
L	T	V	E	T	A	K	I	A	D	A
N	A	A	R	N	J	E	A	P	E	L
D	A	L	A	I	V	A	K	A	N	T
E	D	E	N	P	N	A	D	I	A	M
R	R	E	M	I	R	E	T	I	R	I
T	R	E	S	T	R	T	A	T	E	O
S	M	N	O	T	A	R	E	T	I	N
K	A	A	M	E	R	I	K	A	N	E
E	H	P	A	M	A	D	S	H	E	H
K	O	L	O	N	A	O	T	E	C	E
T	U	N	E	L	E	T	P	E	R	O
T	O	R	N	A	I	T	K	E	S	T
K	A	N	S	A	R	A	H	E	P	E
K	E	T	J	A	C	I	T	A	T	E

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

1				7	5			3	4
							9		
	5	3	6	9					8
3		4		2	7				
	7	8			3	2			
9				8	5				
	9	7	4				5	8	1
	2	5		6		4	9		
				8		7	2		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	6	5	3	2	7	8	1	9
8	7	3	9	1	4	5	2	6
9	1	2	8	5	6	7	3	4
1	8	6	5	3	2	9	4	7
2	3	7	6	4	9	1	5	8
5	9	4	7	8	1	2	6	3
3	2	9	1	6	8	4	7	5
7	5	1	4	9	3	6	8	2
6	4	8	2	7	5	3	9	1

Argëtim filozofik

-Bibla na mëson ta duam të afërmit tonë. Të duam dhe armikun tonë. Ndoshta sepse ata janë të njëjtit njerëz.

-Lotët janë gjuha e heshtur e dhimbjes.

-Bota është e mbushur plot me njerëz të çmendur: nëse nuk doni t'i shihni, mbylluni në shtëpinë tuaj dhe thejveni pasqyrën.

Çdo budalla mund të thotë të vërtetën. Ka nevojë për aftësi për të gënjyer.



Thënie të mençura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	I	11	16		7	5	15	8		3	8	
1	Z	8	13	8	6		6	8		4	3	8	12
2	I	7		10	9	9	2		15	2	11	3	2
9	L		14	8	12	17	12	3	7	9	9	2	
	5	7	15	5	8	5	2	16	8	5		16	
4	8	6	5	2	15	8		7	15		10	7	
7	5	7		12	7	15		6	11	6	8	15	
5	6	4	7		5	2	18	2		11	19	7	
5	4	11	6	19			9	8		4	8	6	
9	11	15		1	7	5	8		19	8	1	8	
7	6	2	14		14	7		16	11	15	7		
5	7	8	4		8	9	3	8	15	7	5		

I	R	S	E	R	B	B	I	D	E	T	
B	E	L	A	M	I	S	R	N	I		
I	I	H	I	P	O	T	E	Z	A	T	
Z	P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T
A	N	E	T	A	R	E	T	L	A	A	
	R	I	T	I	U	I	T	A			
A	T	E	E	M	T	A	I	R	O		
K	E	N	E	T	E	I	T	A	K	A	
T	K	D	T	E	A	N	T	A			
U	N	I	O	N	M	R	T	K			
A	I	M	I	S	I	O	N	A	R	E	T
L	K	S	T	U	R	I	S	T	E	T	

-Sa më shumë lexoni pa menduar, aq më shpejt filloni të besoni se dini shumë, por sa më shumë që mendoni duke lexuar, aq më qartë e shihni se dini shumë pak.

-Njerëzit nuk besojnë gjënjeshtra sepse janë të detyruar, por sepse duan.

-Problemi kur ke një mendje të hapur, është se disa njerëz vijnë dhe insistojnë në vendosjen e gjërave brënda saj.

-Ne prirëmi të besojmë te ata që nuk i njohim sepse nuk na kanë mashtuar kurrë.

